


GJOKË DABAJ

NJË COPË JETË NË VITIN 1955.

(Ditar, shkruar në gjuhën sllave, në moshën 17 vjeç.
Përkthim dhe kompjuterim, 2015, në moshën 77 vjeç)



17 vjeç, nuk kam qenë i vogël. Në këtë moshë shumë njerëz e kanë përcaktuar udhën e vet. Muzikantët, sportistët, inxhinierët, ekonomistët, shkencëtarët, poetët, politikanët e ardhshëm, por edhe profesione më „modestë“, zdruckhtarët, mekanikët, rrobaqepësit, muratorët, që të gjithë, në kushte normalë, në këtë moshë, e kanë bërë startin e vet dhe ecin, me shumë pasion ose me më pak energji, në rrugën që u është ravijëzuar tashmë. Në histori ka madje personalitete të spikatur qysh në këtë moshë: ushtarakë, trashëgimtarë të fronevet, kompozitorë...

Unë, siç do të shikohet edhe në shënimet e këtij ditari, s'isha, veçse një i ri fare i thjeshtë. 1 vit më parë e kisha kryer shkollën 8-vjeçare. Ruaja bagëtitë dhe bëja punë të tjera në shtëpi e rreth shtëpisë. SHKRUAJA NË GJUHË TË HUAJ. NUK DIJA TË SHKRUAJA NË GJUHËN TIME, sado që e flisja përditë këtë gjuhë. Nuk shikoja as edhe 1 perspektivë për jetën time.

Megjithkëto, rreshtat e këtij ditari, e kësaj fletoreje, tregojnë vlerën e madhe që ka, për çdo njeri, të shënuarit në letër të ngjarjeve të ditës. Të ulurit në mbrëmje para një kandili dhe të shënuarit aty, qoftë edhe 2 fjali, nga dita që po mbyllet, e detyron njeriun të kthehet në retrospektivë. E detyron njeriun të shohë vetëveten në kohë të sapokaluar, të bëjë njëfarë bilanci të ditës që po lë pas dhe, doemos, të mendojë edhe për ditën që do të vijë. Gabimet, pengesat, sukseset, dështimet, punët, sado të rendomta qofshin ato, pastaj moti, i keq apo i mirë, përballja me njerëzit dhe me ambientin, ndjenjat, midis të cilave, edhe ajo e dashurisë, miqësitë, shoqëritë, lëkundjet shpirtërore, sëmundjet, të gjitha këto, kur njeriu ulet për të shkruar ditar, do t'i nënshtrohen një analize dhe do ta çojnë ashtu individin në një jetë, gjithsesi më të kontrolluar.

Prandaj dhe po e publikoj këtë ditar: Për t'u treguar njerëzvet të rinj, sa rëndësi ka të shkruarit në fund të ditës, të asaj që tashmë ka kaluar. Të ulesh e të shkruash në fund të ditës të asaj që tashmë ka kaluar, të detyron, ty personalisht, ta shohësh sa e ke veten në dorë, sa i qëndrueshëm je, sa serioz je, sa i preokupuar je me jetën tënde dhe me të afërmit e tu.

Të mosmbajturit, ndërkaq, të një ditari, kur bie fjala për të, nuk i krijon njeriut ndjenjë tjetër, veçse keqardhje: ***Sa kot kam jetuar! T'i kisha shkruar ato që më kanë ndodhur, sot do të mund ta shihja më qartë të shkruarën time.*** Kështu them edhe unë për ngjarjet që më kanë ndodhur, por që nuk i kam shënuar. Ndërsa për këto që i kam shënuar, më vjen mirë. Më vjen mirë, sado që ndonjëherë janë edhe të hidhura.

Më vjen mirë mua, por besoj se edhe pasardhësvet të mi do t'u vijë mirë, sepse do ta njohin më në hollësi paraardhësin e vet.

(Në faqen e parë të brendshme kam llogaritur, me sa duket, moshën e vëllait tim: Prej vitit 1955, muaji 9, dita 6, kam zbritur vitin 1949, muaji 6, dita 6, dhe më ka dalë moshë e vëllait, 6 vjeç e 3 muaj. Kjo nuk ka si shpjegohet ndryshe, veçse me dashurinë e madhe që kisha për vëllanë tim, Palë Kolë Dabajn.)

E shtunë, 1.I.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Në mbrëmje ra borë. Në mëngjes shkova në kishë, ndërsa mbasdite, shëtitje nëpër katund me rastin e Vitit të Ri. Në mbrëmje dyzen te Zef Toma në Krruç, deri në 3 e gjysmë mbas mesnate.

E dielë, 2.I.1955.

Ditë e kthjellët. Në mbrëmje ra shi. Gjithë dita më kaloi e errët, në biseda dhe mendime jo të gëzueshëm, për shkak të një P.N.P. (Ndoshta vajzë, se përemri (neke) është në gjininë femërore. Gj.D.2015)

E hënë, 3.I.1955.

Ditë me shi. Para mbrëmjes shi më i madh, kurse gjatë natës dëgjohet hutini dhe moti po kthjellohet. Ruajta dhentë. Në mbrëmje, te dajë Luboja luajtëm letra. 2 dhen më kanë mbetur në mal.

E martë, 4.I.1955.

Në mëngjes vrënjtur, gjatë ditës diell, kurse në mbrëmje prapë vrënjtur. U çova heret dhe shkova t'i kërkoj dhentë që më patën mbetur mbrëmë përjashta. Më vonë ruajta të tjerat. Ato të 2-ja mbetën prapë përjashta.

E mërkurë, 5.I.1955.

Ditë e vrënjtur, mbrëmja me shi. Unë ruajta dhentë dhe më mbetën prapë 2 përjashta. Në mbrëmje, gosta e gurriqit. Ishin: Lena me të kunatën, Gjergji (i shoqi i hallës Prenë), halla Angjë me Mrikën, halla Palinë, Dila e hallës Mrikë, daja Pjetër, nusja e dajë Lek's, prej dajavet (më të afërm), të gjithë, përveç dajë Gjergjit dhe dajë Gjonit, prej axhet, vetëm fëmijët, ndërsa prej axhë Zefit, ai dhe Maci.

E enjte, 6.I.1955.

Sot, mot me shi. Unë ruajta dhentë. 2 po rrinë jashtë qysh prej së hënës dhe s'po mund t'i gjejmë, megjithse po i kërkojnë, edhe tata, edhe nëna.

E premte, 7.I.1955.

Ditë e vrënjtur, në mbrëmje shi. Unë i kërkoja 2 dhentë e nuk i gjeta. Por i gjeti tata poshtë Gurit të Llanishtës. Në mbrëmje kemi ndenjtur te daja Gjergj dhe kemi shirë misër për blojë.

E shtunë, 8.I.1955.

Deri më 10, shi, më vonë vrënjtur. Në mëngjes shkova për dru dhe, për rrugë, përcolla edhe qetë. Më vonë, puna ime kryesore ishte, të shkoja në mulli. Në mbrëmje ndenjëm te axha Zef deri në orën 11.

E dielë, 9.I.1955.

Mot i ndërrueshëm. Në mëngjes shkova në kishë dhe, kur po kthehesha, shkova në shkollë për të dëgjuar ligjëratën "*Mbi të drejtat e njeriut*". Para mbrëmjes i dola tatës përpara, se do të shkonte në gostë të gurriqit te halla Angjë. E humba briskun tim të dashur.

E hënë, 10.I.1955.

Mot i vrënjtur. Ruajta dhentë dhe i humba 4. Para mbrëmjes nxora nga Ferrza shumë lopë.

E martë, 11.I.1955.

Në mëngjes dola dhe i kërkoja ato 4 dhentë dhe i gjeta afër Ferrzës. Ditën ruajta tufën. Në mbrëmje, ndenjje te Osman Kordiqi deri në 12. Ditë me shi.

E mërkurë, 12.I.1955.

Sot gjithë ditën ra një shi i imët. Ruajta dhentë. Në mëngjes jam nervozuar shumë prej tyre, sepse mbeteshin prapa dhe ndaheshin nga tufa. Më vonë më kaloi nervoza. Sonte i ndalëm në Ograjë.

E enjte, 13.I.1955.

Kam djegë qymyr prej dëllinje (eshk) dhe më është mbushur mendja se s'ka levërdi prej asaj pune. Koha, e vrenjtur.

E premte, 14.I.1955.

Ditë e vrënjtur e në mbrëmje shi. U nisa në mëngjes për në Togjemil. Mora me vete 3000 dinarë që i ka pasë dhënë Muho Ishmaku për drutë e Ograjës. Për rrugë mora edhe eshkun, që e shita 400 dinarë. Bleva 5 metra pëlhurë, 1000 dinarë dhe vogëlsira të tjera. Në mbrëmje shkova te Sulo Smaku, të bisedoj për prerjen e druvet.

Marrë me vete 3007 dinarë, fituar 400 dinarë. Gjithsej 3407 dinarë. Shpenzuar: 1000 pëlhura, 73 sheqer, 10 shkrepëse. Mbetën 2324 dinarë.

E shtunë, 15.I.1955.

Ditën, gjysmëkthjellët, në mbrëmje po fryn erë. Në mëngjes shkova me pre dru për t'i shitur. I shita për 200 dinarë. Mbas dite preva edhe një gomar dru për nesër.

Mora me vete 324 dinarë. Fitova 200 dinarë. Shpenzova, 350 për një pompë të vogël dhe 24 dinarë marmelatë. Më mbetën 150 dinarë.

E dielë, 16.I.1955.

Në mëngjes u çova vonë dhe u nisa për në Ulqin. Udhëtova gjithë ditën si pa qejf. Gomari nuk ecte e unë isha i mërzhitur për shkollën, që e lashë vitin e kaluar. Arrita vonë te shtëpia. Dita që e kthjellët e në mbrëmje vrënjtur, me erë shumë të fortë.

Marrë me vete 2150 dinarë, fitova prej druvet 150 dinarë. Gjithsej 2300 dhe ia dhashë tatës.

E hënë, 17.I.1955.

Sot, mot i mirë. Ruajta dhentë dhe herëpas'here shihja mos i gjej ato 2, që i kishin humbur nënës mbrëmë. Më në fund i gjeti nëna, por sërish na mbetën në mal. Gjithë ditën isha qejfprishur. Në mbrëmje, të ndenjtur te Rizai deri në 12.

E martë, 18.I.1955.

Moti i trazuar. Gjithë ditën ra shi i shoqëruar me erë të madhe. Pasi i gjetëm ato 2, shkuam të 2 për t'i ruajtur, që të mos na humbnin prapë, por më kot, sepse na mbetën në mal 3 të tjera. Në mbrëmje rashë heret.

E mërkurë, 19.I.1955.

Në mëngjes një re shiu, më vonë mot i mirë. Në mbrëmje ftohtë. Në mëngjes kërkova ato 3 dhentë dhe i gjeta. Pastaj ruajta tufën dhe i solla të gjitha në shtëpi, shyqyr Zotit! Në mbrëmje erdhi tata prej Togjemilit, gjegjësisht prej Tivarit, dhe atje e kish rregulluar deri diku punën e arës që kemi në Zalef.

E enjte, 20.I.1955.

Sot ishte mot i mirë. Erdha në Togjemil me mendimin që të fitoj ndonjë dinar e të blej ushqimet. Në mbrëmje ndenja deri vonë, sepse arnova opingat. I prisha një palë të vjetra të tatës dhe u vura siprinat e të miavet.

E premte, 21.I.1955.

Fryn veriu e qielli është i vrënjtur. Unë i preva 5 gomarë dru në Dushak dhe prej tyre, një e çova në Tivar, gjegjësisht në Maroviq, për 200 dinarë. Në mbrëmje po ndiej lodhje të madhe.

E shtunë, 22.I.1955.

Sot mot i mirë. Deri në mesditë kam çuar 2 gomarë dru në Maroviq, mbasdite udhëtova për Shestan. Në mbrëmje, valle te Gjeka i Macit në Lukiq.

Llogaria e sotme: Kam marrë me vete 350 dinarë, fitova 400 dinarë. Shpenzimet: 503 dinarë furnizim (Sipas listës që caktohej nga shteti e që sllavisht quhej trebovanje. Gj.D .2015), 20 dinarë bukë, 10 dinarë marmellatë, 30 dinarë qethje, 120 dinarë kuotat e anëtarësisë për tatën e nënën (Siç duket, të organizatës së Frontit. Gj.D.2015), 2 dinarë më ranë në ujë. (Dinarë gjendje duhej të dilnin 65, por aty janë shënuar 15. Gj.D.201

E dielë, 23.I.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Në mëngjes më zgjoi axha Nikë dhe u nisa për në Ulqin. Zbrita në Tivar, mora gomarin dhe vazhdova udhëtimin. Në mbrëmje shkuam te Hysë S. Lakoviqi, se i kish vdekur e shoqja.

E hënë, 24.I.1955.

Sot, gjysmëkthjellët. Mbasdite vrënjtur. Rreth mesditës kam korrur pak bar poshtë Pusit të Rrenimit, ndërsa para mbrëmjes kemi prerë dru, unë dhe nëna. Në mbrëmje rashë heret.

E martë, 25.I.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Unë udhëtoj nga Ulqini në Togjemil, ku mendoj të rri disa ditë dhe të pres dru me metër kub. Në mbrëmje, Kolë Maleviqi më bëri bishtin e kadhës.

E mërkurë, 26.I.1955.

Sot është mot i kthjellët. Unë preva dru gjithë ditën prapa Veli Kamenit. U lodha bajagi, se nuk jam mësuar me punë aq të rëndë.

E enjte, 27.I.1955.

Mot i mirë. Çava drutë që pata prerë dje dhe i vendosa në metër kub. Më dolën 2 metra e pak më shumë. Preva dhe pak dru frashëri dhe, deri në mbrëmje, u bënë 2 metër kub e gjysmë.

E premte, 28.I.1955.

Moti i vrënjtur. Bajta me gomar, deri te linja e hekurudhës, drutë që i pata çarë dje, dhe i stivosa në metër kub. Paradrive pashë një ëndërr interesante, sikur nëna më ish mbytur në det.

E shtunë, 29.I.1955.

Moti në shi. Transportova dru në Luticë. Më kapi roja e pyjevet, Vaso Markoviqi, por më tha se nuk do të më denonconte.

E dielë, 30.I.1955.


Moti, i mirë. Në mëngjes shkova në Luticë për të parë nëse do të vinte ai njeriu, me të cilin është ujdalur Kolë Maleviqi për drutë e mia. Meqë ai nuk kish ardhur, unë

vazhdova rrugën për në Tivar Poshtë, ku dhe mora vesh që nuk i donte drutë ai, por dikush tjetër. Shkova edhe atje, dhe ai më premtoi se do të vinte nesër.

E hënë, 31.I.1955.

Në mëngjes, te treni, por më kot. Bllagota nuk kish ardhur. Shkova në Tivar Poshtë dhe e gjeta. Ai më dha kaparin 1000 dinarë dhe tha se do të vinte nesër për t'i marrë drutë.

Llogaria: 1000 dinarë nga drutë. Shpenzuar 430 dinarë. (Por s' del e qartë përse është bërë shpenzimi. Gj.D.2015)



E martë, 1.II.1955.

Moti është i vrënjtur. Shëtita nëpër Togjemil e Zupç me Fran Kolloviqin, i cili mbrëmë pat ardhur te unë me pak duhan. Bllagotë Mijoviqi erdhi për të parë drutë, por nuk i pëlqyen. Nuk i kisha stivosur mirë.

E mërkurë, 2.II.1955.

Ditë me shi. Preva dru gjithë ditën pas Veli Kamenit.

E enjte, 3.II.1955.

Në mëngjes shkova në Luticë, ku pat ardhur Bllagotë Mijoviqi për drutë. Atij prapë nuk i pëlqyen drutë dhe donte të tallej me mua. I ristivosëm, i shtova edhe disa dru dhe, më në fund, i mori. Pastaj çava dru të tjera. Ishte mot i mirë. Bllagota më dha 2000 dinarë, kurse 300 i mbajti, sepse nuk u bënë tamam 3 metra. U morëm vesh që t'ia çoja në stacion të Zupçit një kalë dru e ai, pastaj, të m'i dërgojë paret.

E premte, 4.II.1955.

Ditë e vrënjtur. Deri në mesditë çava dru, kurse pasdite preva të tjera. Në mbrëmje erdha i lodhur. Ndenja pak te Kola, sepse kish ardhur Dila nga Ulqini dhe më lajmëroi se prindët e mi dhe Pala ishin shëndosh e mirë.

E shtunë, 5.II.1955.

Mot i mirë. Çova dru në Luticë. Bëra 11 rrugë. U bënë gati 2 metra kub. Në mbrëmje më erdhi Fatma e Isufit për të ndenjtur.

(Shënim për datën 3 shkurt): Ka pjellë Kapurja e Ramos.

E dielë, 6.II.1955.

Ditë me shi. Në mëngjes mpreha kadhën dhe sëpatën në qostër te Nikolla, ndërsa më vonë shkova në Tivar Poshtë, me qëllim që të ujdise me dikënd për t'i shitur ato 2 metra dru. I ujdisa me Bozho Preleviqin, por paret do t'i marr pas datës 22 të këtij muaji. Në mbrëmje isha për darkë te Kola. Ka pjellë Lakuqja e Mujovicës.

E hënë, 7.II.1955.

Paradita ish me shi, ndërsa mbasdita e vrënjtur. Në mbrëmje sërish shi. Preva 3 gamarë dru, me të cilët i plotësova ato 2 metra kub të Bozho Preleviqit dhe 1 gomar e çova te stacioni i Zupçit për Bllagotë Mijoviqin.

E martë, 8.II.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Udhëtoj nga Togjemili për Ulqin. Në mëngjes shkova në Zupç para trenit, për të parë a i kish nisur Bllagota ata 300 dinarë. Për udhë mora furnizimin, 42 kg miell. 2 kg ia dhashë Marës së Nikollës, se nuk pata pare për t'i marrë. Në vend të Bllagotës, m'i dha Kola 300 dinarë.

Marrë me vete 2037 dinarë. Mielli: 1869 dinarë, 70 dinarë postim letre, 20 dinarë bukë, 30 dinarë tabelë shkrimi për Palën, 8 dinarë kunjë për të shkruar në tabelë, 2 dinarë zarfi.

E mërkurë, 9.II.1955.

Para dite vetëm vrënjtur, mbasdite shi i madh. Në mëngjes shkova te tata në Qengël. Kish pjellë Shara Pikaloze e Ramos, kurse në natje, te shtëpia, Gala e Gjatë e Ramos. Ditën, unë edhe nëna, mblodhëm Nën Llogore pak bar për qetë.

E enjte, 10.II.1955.

Gjatë ditës, mot i mirë, kurse para mbrëmjes, shi. Bëra mur në baçe. Para mbrëmjes shkova te tata. Atij i kishin mbetur jashtë 9 dhen. 5 i gjetëm sipër Rrugës së Shkinavet. 4 kishin ardhur vetë dhe rrinin pas murit, sipër Ograjës.

E premte, 11.II.1955.

Ndaj të gdhirë ra shi, kurse ditën mot i mirë. Bëra mur sërish në baçe, gjithë ditën. I rindërtova në disa vende muret e prishur.

E shtunë, 12.II.1955.

Deri në mesditë mot i mirë, pasdite gjysmëkthjellët. Mbarova ngritjen e murevet në baçe. Në mbrëmje shkova t'i çoj darkën tatës. Për darkë kishim nandajën mysafire.

E dielë, 13.II.1955.

Moti me shi. Në mbrëmje shi më i madh. Nuk munda të shkoj në kishë, ca se u zgjova vonë, ca edhe prej përtësës. Ndenja një copë herë te dajë Luboja, ndërsa para mbrëmjes shkova te tata. Natën, valle te Ramo Kollareviqi, deri më 1 mbas mesnatet.

E hënë, 14.II.1955.

Ditë e vrënjtur. Në mëngjes ua pastrova kasollen dhenvet pleja. Më vonë kam shkukur rryella në baçe, kurse mbasdite prapë jam marrë me pastrimin e stallës së qevet. Në mbrëmje shkova t'i çoj darkë tatës. Në Ograjë gjeta 3 krerë gjedhë të Zef P.Dediqit, madje duke kullotur elbin.

E martë, 15.II.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Para dritet ka rënë pak borë. Në mëngjes shkova te tata dhe atje kishin pjellë 4 dhen. E pata pak vështirë t'i sjell deri në shtëpi. Mbasdite kam gdhendur dhe rregulluar parmakët, që të bëj veçimin e oborrit për dhentë pleja.

E mërkurë, 16.II.1955.

Gjithë ditën ra shi. Në mëngjes shkova te tata dhe mora vesh që mbrëmë kish mbetur një dele përjashta. E kërkova gjithë ditën. Në mbrëmje, shamatë e madhe me axhën, gjegjesisht, ai bërtiste shumë dhe na fyente rëndë, aq sa njeriu detyrohet të bjerë në pozita jonjerëzore. Nuk po di, a është kjo farë taktike apo thjeshtë llototitje pa lidhje. Ai e kishte goditur djalin e Nikë Junkoviqit, duke e akuzuar pse kanë hyrë gjedhët e dikujt në tokën tonë nëpërmjet tokës së tij.

E enjte, 17.II. 1955.

Moti i vrënjtur. Kërkova një dele, e cila ka mbetur jashtë qysh me 15. Duket se ka pjellë në mal. Para mbrëmjes ruajta dhentë në arën që i thonë Vorreze.

E premte, 18.II.1955.

Mot me shi. Ruajta dhentë pleja, me gjithë qingja, në Vorreze, diku reth 2 orë. Në mbrëje rashë heret.

E shtunë, 19.II.1955.

Mot i vrënjtur. Ruajta shterpat në mal. Në mbrëmje luajtëm valle te Ramo Kollareviqi deri në 2 e 30. (Është shënuar gabim, 14 e 30. Gj.D.2015)

E dielë, 20.II.1955.

Deri në mesditë mot i mirë, pasdite shi. Ruajta dhentë dhe në mbrëmje fjeta në Ograjë pranë dhenvet.

E hënë, 21.II.1955.

Ra borë, por, në malin tonë, nuk zuri dhe nuk qëndroi. Ruajta dhentë dhe në mbrëmje më mbeti jashtë Lakuqja jonë.

E martë, 22.II.1955.

Mot i vrënjtur. Në mëngjes kërkova Lakuqen, e gjeta pa qengj dhe e solla në shtëpi, i bindur se do t'ia ketë rrëmbyer dhelpira. Në pjesën tjetër të ditës, ruajta dhentë e tjera. Në mbrëmje ndenjëm te daja Lubo.

E mërkurë, 23.II.1955.

Deri në orën 11 vrënjtur, pastaj shi. Ruajta dhentë dhe në mbrëmje erdha në shtëpi krejt i lagur. Sot fillojnë kreshmet.

E enjte, 24.II.1955.

Mot i vrënjtur. Udhëtova për Togjemil. Në mbrëmje shkova te Halili, çova grurin, që të bluhet për nesër.

Logaria: 10 dinarë shkrepëse.

E premte, 25.II.1955.

Ditëlindja. Pesha 58 kg, lartësia 157 cm, gjërësia e supevet 41 cm, perimetri në gjoks 74 cm. Mot i vrënjtur. Në mëngjes shkova në Tivar Poshtë dhe u zura me Bllagotën, pastaj m'i dha 300 dinarët. Në pjesën tjetër të ditës, udhëtoj për në Ulqin. Stankoja i Stevos më dha 500 dinarë të Franit.

Llogaria: 90 dinarë bukë, 50 dinarë vaj për flokët, 50 (fjalë e pakuptueshme), 100 dinarë 4 gota për çaj, 40 dinarë spango për opingat e dajë Lubos, 10 dinarë letra cigaresh.

E shtunë, 26.II.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Në mëngjes preva një gomar dru dhe i gjeta 3 shelegët që i kishin mbetur tatës jashtë që më 24. Më vonë erdha te shtëpia dhe bëra pak mur në oborr. Në mëngjes kam pastruar ullinjtë nga pjesët e kalbura. Në mbrëje arnova opingat e mia.


E dielë, 27.II.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. Në mëngjes shkova në kishë me Macin dhe me axhën Nikë dhe u kthyem në mesditë. Mbasdite dolëm (me Macin) para dhenvet, të cilat, këto ditë kemi filluar t'i nisim në mal të pashoqëruara me bari. Kemi biseduar mbi gjëra që na interesojnë ne të rinjvet dhe po vë re që (Maci) nuk fsheh asgjë prej meje.

E hënë, 28.II.1955.

Mot i mirë, me pak vranësira. Udhëtova prej Ulqinit në Togjemil, me qëllim që të shes ca patate. Për rrugë, bleva një palë opinga të reja te Fadili në Tivar Nalt. Para mbrëmjes u takova me mbesën e mullisit të Togjemilit S.Z.SH.A. d.pr. (Inicialet dhe shkurtesat e fundit nuk i "deshifroj" dot. Gj.D.2015)

Ky muaj, në përgjithësi, më shkoi mirë. Kam qenë më shumë me gjendje shpirtërore të rregullt, se sa i dëshpëruar. 7 ditë i kalova në Togjemil. 4 herë e kamë bërë rrugën Ulqin-Togjemil. 9 ditë kam ruajtur bagëtinë. 6 ditë argëtim dhe ndenjje te shtëpia. 2 ditë shetitje.



E martë, 1.III.1955.

Gjithë ditën ra shi. Është interesant, se, në pjesën më të madhe, më një anë binte shi, m'anë tjetër ngrohte dielli. Nuk munda të punoj asgjë, e kalova ditën i dembelosur, herë te Kola, herë te Halil Periçiqi.

E mërkurë, 2.III.1955.

Sot ra 2 herë borë dhe fryu erë e madhe në Togjemil. Solla 2 rrugë patate nga Murrizet.

E enjte, 3.III.1955.

Gjysmëkthjellët, por në disa vende fryn erë e madhe dhe është shumë ftohtë. Puna ime kryesore ishte, të shkoj nga Togjemili në Gurrzë. Për rrugë nxora një gropë patate dhe i zbrita nga Murrizet në Gurrzë, që t'i kem gati për nesër. Në mbrëmje e prisha kreshmen me djathë, pa dashje.

E premte, 4.III.1955.

Moti i kthjellët, por fryn veriu dhe është shumë ftohtë. Isha në Vir, për të shitur patate. 500 dinarë ia dhashë Fran Kolloviqit, që ia kam shpenzuar më 28.II.

Llogaria e sotme: 1845 dinarë patatet (me nga 45), shpenzuar 610, në xhep 1235 dinarë. Shpenzimet: 500 Franit, 41 peshorja, 45 ëmbëlsirë, 24 qerasur dikënd.

E shtunë, 5.III.1955.

Në mëngjes pak ftohtë, pastaj mot i mirë. Puna kryesore: thirra Macin e Gjok's Per's, që më vendosi një bravë në derën e shtëpisë në Gurrzë. Mbasdite për në Togjemil dhe për rrugë çova një gropë patate. Në mbrëmje ndenja te Kola.

E dielë, 6.III.1955.

Mot i vrënjtur. Çova një gomar me patate në Nëngjytet, që të jenë gati për nesër. Pastaj shkova të shoh Lenën e Gjur's Macit dhe shoqen e Gjok's, se janë sëmurë. U ktheva në Zalef te nuna. Ajo më dha 100 dinarë dhuratë. Shkova për naftë në Topolicë, por më kot.

E hënë, 7.III.1955.

Sot vrënjtur. Udhëtoj nga Tivari për Ulqin. Në mëngjes më dha Duroja e Velisë 400 dinarë për patatet që ia pata çuar mbrëmë. Në Tivar shita 45 kg patate.

Llogaria: 1735 dinarë me vete, 1670 bënë patatet, gjithsej 3305. 1500 çova në shtëpi. Shpenzimet: 1300 dinarë 2 këmisha, 400 Beqo K. e të tjera.

E martë, 8.III.1955.

Ruajta dhentë plleja në grurin e Rizasë. Pasdite kam kërkuar shterpat, të cilat i lëshojmë pa bari. Moti me shi.

E Mërkurë, 9.III.1955.

Moti i mirë, me pak re. Në mëngjes i ndihmova tatës për t'i përcjellë pllejat, sepse kemi filluar t'i ruajmë në mal. Pjesën tjetër të ditës kam thurur një gardh në oborr. Në mbrëmje erdha vonë me shterpat.

E enjte, 10.III.1955.

(Ka vetëm disa llogari. Gj.D.2015) 2 kg pashtë (?) – 210, 2 kg sheqer – 350, 1 kg oriz – 180, 1 litër vaj – 500, 1 litër raki – 600, 6 litra verë – 480. Gjithsej 2320.

E premte, 11.III.1955.

(Prapë disa llogari. Gj.D.2015) Gotë uji – 100. Një këmishë – 1200, një palë opinga – 800, një kanotiere – 450, gjithsej (pa gotën e ujit) – 2450, koin. (fjalë e pakuptueshme) – 360. Gjithsej – 2780, vogëlsira të tjera – krejt shpenzime – 3000)

E shtunë, 12.III.1955.

(Ka vetëm 4 firma në gjuhën sllave, Gj.D.2015) Gjoka Daboviq.

E dielë, 13.III.1955.

Mot i vrënjtur. Gjithë ditën përtacërova nëpër katund. Në kishë nuk shkova, vetëm prej paineresimit. Në mbrëmje ia çova Lubicës 20 kg patate – 800 dinarë.

E hënë, 14.III.1955.

Dita gjysmë e kthjellët. U çova heret dhe u nisa për në Tivar. Atje shita 21 kg patate me 40 dinarë dhe 2 kg me 30 dinarë. 20 dinarë peshorja, 20 dinarë bukë, 16 dinarë sheqer, 30 dinarë 2 gjilpëra, gjithsej 86 dinarë (shpenzime). 840 dhe 60, gjithsej 900 dinarë nga patatet. (Këtyre u kam shtuar, pa shpjegim) 800 dhe 2574, gjithsej 4274 dinarë.

E martë, 15.III.1955.

Moti i vrënjtur. Kam punuar kopshtin për qepë. Në mëngjes i pata hedhur plehun. Për darkë na erdhi Vojin Janinoviqi.

E mërkurë, 16.III.1955.

Mot i mirë. Deri në mesditë miha dhe e mbarova kopshtin për qepë dhe për hudhra. Pastaj shkula rryej.

E enjte, 17.III.1955.

Në mëngjes mbolla patate në atë pjesë të kopshtit që nuk u plotësua me qepë = 29 m katrorë. Pastaj e punova për patate pjesën tjetër të kopshtit.

E premte, 18.III.1955.

Në mëngjes udhëtova për në Tivar, me qëllim që të shlyej një pjesë tatimevet. Për rrugë u ndala te nuna në Zalef, që të merrja 1000 dinarë, se do t'i blente diç nëna. Për tatim dhashë 2000 dinarë. Në mbrëmje u ktheva në Krythë. Moti, i vrënjtur.

E shtunë, 19.III.1955.

Sot moti gjysmë i kthjellët. Është Dita e Shnozefit. Në mëngjes shkova në Kishën e Shnozefit në Bisht të Malit.

E dielë, 20.III.1955.

Sot mot i mirë. Ruajta dhentë gjithë ditën.

E hënë, 21.III.1955.

Moti gjysmë i kthjellët. Kërkova nëpër mal Murronjën tonë dhe të dajë Lubos. I gjeta në Ullishtë. Para mbrëmjes shkula pak rryej në baçe.

E martë, 22.III.1955.

Gjithë ditën ra shi. Nëna ish e sëmurë, unë ndenja gjithë ditën rreth saj.

E mërkurë, 23.III.1955.

Mot i mirë. Ruajta qingjat, shkula rryej në baçe etj.

E enjte, 24.III.1955.

Mot i mirë. Në fillim kërkova qetë (në mal), pastaj bëra pak mur te kopshti dhe në vazhdim ruajta qinjgjat në arë.

E premte, 25.III.1955.

Mot i mirë. Në mëngjes kërkova qetë. Pasdite punova pak në kopsht dhe mbolla 3 rrënjë hardhi.

E shtunë, 26.III.1955.

Mot i mirë. Ruajta dhentë. I humba 9 kokrra, të cilat erdhën vetë në shtëpi.

Nga 26.III deri më 18.IV. nuk kam mbajtur ditar, më shumë prej nënvleftësimit, se sa prej pamundësisë. Në këto ditë nuk ka asgjë të rëndësishme. Pala, tata dhe nëna ishin me radhë të sëmurë nga gripi. Unë qeshë sëmurë pikërisht Ditën e Pashkëve. Ditësh tjera kam ruajtur dhentë. Për Pashkë ra pak shi.

E hënë, 18.IV.1955.

Sot mot i mirë. Fryn nga pak erë. Ruajta dhentë dhe i solla të gjitha në shtëpi.

E martë, 19.IV.1955.

Sot mot i mirë. Unë desha të qes pleh në Vorreze, por i ka vdekur një vajzë e vogël Rizait dhe nuk munda të punoj andej para se të varrosej. Pas varrimit, shkova 10 herë me gomar.

E mërkurë, 20.IV.1955.

Mot i mirë. Ruajta dhentë. Në mbrëmje rashë heret. (Këto ditë po përpiqem të takohem me Z.O.M, se s'po dua të shkoj në Shestan pa folur me të.)

E enjte, 21.IV.1955.

Mot i mirë e në mbrëmje pak erë. Lërova gjithë ditën në Vorreze dhe e mbarova.

E premte, 22.IV.1955.

Në mëngjes e ndjeva që do të më kapte një grip i keq, i cili në këtë kohë është i përhapur gjithandej në popull. Gjithë ditën më ka dhembur fyti. Ruajta dhentë. Moti ish i mirë.

E shtunë, 23.IV.1955.

Sot kam ditën e emrit. Kemi therur një qengj të vogël dhe kemi thirrur për drekë te daja Gjergj, te daja Lubo, te daja Pjetër, te daja Lekë. Prej dajet Pjetër nuk erdhi asnjë. Në mbrëmje shkuam për festë te daja Gjergj, sepse edhe ai e ka Shën Gjergjin ditë emri. Moti ish i mirë. Unë nuk po ndjehem mirë prej gripit. Mbasdite shkova edhe në Braticë për të takuar Z.O.M.

E dielë, 24.IV.1955.

Ishte mot i mirë. Shkova në kishë. Mbasditën e kalova te daja. Para mbrëmjes dola në mal dhe kërkova lopët. Sëmundjen po mundohem ta kaloj më këmbë.

Misisipi. Misisipi.

E hënë, 25.IV.1955.

Sot erdhëm me bagëtitë në Togjemil. Udhëtuam mirë, por unë jam i sëmurë dhe me zor kam ecur. Vëllai 6-vjeçar, Pala, e bëri më këmbë rrugën nga Ulqini në Togjemil. Rugës na humbi qeni.

Bur, bruh, bruh.

(Vargje shqip, me shkrim cirilik... Për të shmangur keqkuptimet, emrat e personazhevet i ndërrova. Gj.D.2015)

Xhemal Kasmi po i del tpara/ Mos ne ban ata Zef Lala/ Mos ashtu Zefa he burr/
Se kjo pun nuk ka kjen kurr/ Se dynjaja gjaqet falin/ Jo tata s'po falën djalin/ Se
sot vakti kshtu ka arll/ Cillën t'duojsh at me marr/ Sot s'shigohet ku t'thon
gjin'ja/ Nër gjin t'pasun e zenjina/

6 qershor 1955, shitur djathë, 3,5 kg – 1050 dinarë.

10 qershor 1955, shitur djathë, 4 kg – 1200 dinarë.

25 qershor 1955, shitur djathë, 10 kg – 3000 dinarë.

21 korrik 1955, i çuam djathë Mujovicës, 6 kg (i detyrohemi edhe 7 kg).

(I është dhënë në një datë tjetër.)

A MË MIRË FSHATAR APO PUNËTOR?

Dikush thotë që jeta e fshatarit është më e mirë, ndërsa dikush prapë pohon që punësoria jeton më mirë. Mirëpo ne, njerëzit që duam ta vërtetojmë secilin fakt, nuk do të dëgjojmë, si të thuash, asnjë mendim shabllon. Do të vihemi në ndjekje. Ajo ndjekje ka për të zgjatur shumë, sepse disa njerëz, që dinë ta vënë trurin në punë, do të thonë: *“Sot, në socializëm, edhe fshatarësia, edhe punësoria, i kanë të drejtat të barabarta.”* Po, të drejtat i kanë të barabarta, si punësoria, ashtu edhe fshatarësia, sepse këto të drejta i kemi fituar me luftën e përgjakshme 4-vjeçare kundër borgjezisë dhe fashizmit, por, a jetojnë ata njësoj?..

Duke kërkuar këtë përfundim, vijmë te matematika... E unë mendoj që pikërisht këtu do të gjejmë diçka. E di me siguri që lexuesi do të mëdyshet këtu. *“Si të gjendet në matematikë jeta e fshatarëve dhe punësorëve?”* Por unë do të të orientoj, i dashuri lexues, qoftë edhe sikur ti të jesh një njeri i madh.

Në algjebër mund të gjejmë, edhe nëse ai ndoshta nuk ekziston, një të këtillë ushtrim: Kasemi ka 2 rrallë tokë, 5 ari kopshtinj, 1 gomar, 2 qe dhe 12 kokrra dhen. Dhi nuk ka. Ka për të ushqyer 4 fëmijë, 2 deri në 8 vjeç dhe të shoqen. Jovani është punëtor. Ai nuk ka kurrfarë pasurie, përveç shtëpisë dhe 9 ari kopshtinj. Është drejtues lokomotive dhe merr 12000 dinarë rrogë në muaj, si dhe 18000 dinarë kompensime, sepse i ka 6 fëmijë. Kush jeton më mirë?

Le t'i hyjmë tash punës, unë si shkrues dhe ti si lexues. Unë i njoh, edhe Kasemin, edhe Jovani, sepse pikërisht para 1 viti kam mbledhur në fshatin e tyre disa këngë popullore. Para se të fillojmë me llogaritjet, po të kallëzoj se Jovani ishte i veshur si një princ, ndërsa Kasemi kish një veshje shumë më të thjeshtë se Jovani. Por, në bisedë, kam vënë re që Kasemi ishte ku e ku më i mançur se Jovani. Po shpresoj që, në rrjedhë të kohës, Kasemi do ta mbizotërojë dhe ngushtojë Jovani, aq sa ai të mos ketë nga t'ia mbajë, veç të dëgjojë urdhërat e Kasemit.

Le të kalojmë tani te ushtrimi. Toka e tij është, pa dyshim, joprodhuese, siç edhe i kanë zakonisht katundarët nëpër male. Pa pleh, siç thuhet, ajo nuk prodhon dot as misër. Gjithsesi, atij i duhen 2 ditë për ta lëruar, 2 ditë për ta përzier ugarin dhe,

për ta mbjellë, 4 ditë, sepse djali i tij do të qesë farën. Bëhen gjithsej 8 ditë punë. Shkojmë më tutje. Misri, kur të mbijë, duhet të mihet. Aty i duhen 4 ditë. Nëse dëshiron që t'i bëhet misër të paktën për pulat, ai duhet ta mihë atë 2 herë. Bëhen gjithsej 16 ditë pune dhe 3-4 ditë për ta korrur e prurë në shtëpi, plot 20 ditë pune. Sasia mesatare e misrit që prodhohet në aq tokë është diku te 150 kg në vit. Kur ta llogarisim në të holla, siç shitet këtu në Bregdetin Malazias, prej 150 kilogramësh misër mund të merren 6000 dinarë.

Pra, për 20 ditë fshatari ka fituar 6000 dinarë. Dhe jo ditë të zakoshme pune 8-orëshe, por ditë pune katundarësh, të cilat zgjasin e pakta 14 orë. Kjo do të thotë që, me 30 të tilla ditë pune 14-orëshe, fshatari do të fitojë 9000 dinarë, ndërsa rroga mesatare e punëtorit është 20000 dinarë, megjithse Jovani i merr rafsh 30000 në muaj.

Vetëm me kaq mund të nxjerrim përfundimin, si jeton Jovani dhe si jeton Kasemi. Le t'i bëjë tash krahasimet e shifrave secili njeri i mençur: 9000 me 20000! Kjo do të thotë se punëtorët jetojnë dyfish më mirë se sa fshatarët.

Megjithatë, Kasemi do të pranonte që e ardhura e tij mujore të ishte kaq, por ka aty ditë që nuk kalojnë pa punë, por kalojnë pa fitim. Bagëtitë duhen ruajtur, duhen kullotur, dhe, si të ketë pak, si të ketë shumë, dita duhet humbur me to. Fëmijët janë të parritur, pra, duhet nëna të rrijë me ta. Ajo duhet t'i mbajë e t'u krijojë të gjithë kushtet që u duhen, siç thuhet, me thonj e me dhëmbë.

Mendoj që këtu ka argumente të mjaftueshëm, që mund t'i shikojë gjithkush. Por edhe me gjithë këto vuajtje të fshatarit, disa... (tash nuk po dua t'i përmend me emra), as që shqetësohen fare për fatin e tyre.

Punëtori, në radhë të parë, nuk paguan asgjë nga ato të holla që i shtie në xhep, as tatim, as taksë kullote. Spitalin nuk e paguan, as ambulancën, dhe është i siguruar prej çfarëdo fatkeqësie eventuale.

Ai kopsht i vogël do t'i japë mundësi Kasemit të paktën të mos i blejë qepët edhe lakrat. Penën e qevet as që mund t'ia përmendim, sepse ai është i detyruar të paguajë për dimërimin e tyre po aq sa kushtojnë për t'i blerë. Ndëkaq, gomarin duhet t'ia përmendim, sepse Kasemi e do atë më shumë se çdo gjë tjetër që ka. E shoh përherë duke çuar dru me të në pazar. Edhe nëna e tij e moçme, si i thonë fjalës, jam i sigurtë që kish për të thënë se Kasemi, në saje të krahet të vet dhe gomarit, edhe tatimin arrin ta paguajë, edhe fëmijët arrin t'i ushqejë me bukë thatë.

Lidhur me pajisjet e shtëpisë dhe veshjen e familjes së Kasemit, nuk do të flasim shumë, sepse ai nuk ka qenë në gjendje asgjë të ripërtrijë, çdo gjë i ka mbetur ashtu siç ia kanë lënë të parët. As është në gjendje të ndërtojë shtëpi, as të ripërtërijë diçka në shtëpi.

Për këtë çfarë paraqita deri tash, dikush mund të më kritikojë keqas. Midis tjerash, ndoshta do të më thotë: *Le ta lënë fshatarët e tu të munduar pronën e vet dhe le të kalojnë në punëtori. Në atë mënyrë, për një kohë të shkurtër, ata do ta përmirësojnë gjendjen e vet.* E unë atëherë do t'i përgjigjem: *Kush të mbetet pastaj në fshat? Kush ta punojë tokën e të parëvet të tyre?* Edhe kështu, një numër i madh fshatarësh i kanë braktisur pronat, ato prona që vetë ata i kanë ushqyer e rritur.

E nëse kritikuesi do të ma përmendë kooperativën fshatare, unë kam për ta çuar atë te Kasemi, sepse ai e di mirë si kanë shkuar punët atje. Dhe ai do t'ia dëshmojë që katundarët nuk janë mësuar të punojnë nën mbikqyrjen e dikujt tjetër, përveç të vetin dhe të kryefamiljarit.

Jam i bindur që Kasemi, si një përfaqësues i fshatarësisë në këtë shkrim, do të shprehet me vendosmëri: *“Më mirë si fshatar të vuaj nga uria, se sa të kem çdo gjë me bollëk nën mbikqyrjen e të huajit”*.

Sapo i ka derdhur Dielli rrezet e veta sipër kodrinavet dhe mbi rrafshnaltë. Dallëndyshtet ka kohë që kanë fluturuar prej çerdhevet të veta dhe me përkushtim mbledhin ushqim për të vegjlit e vet. Bletët, duke zukatur qetas, dalin prej kosherevet dhe shkojnë për diku larg, që, nga lulja në lule, thërmi për thërmi të mbledhin mjaltin. Pula kllukë ka dalë që heret nga qymezi dhe shpupurish pa u lodhur bashkë me zogjtë e vet nëpër rërë, ndërsa këndezi fluturon prej gardhit në gardh dhe prej murit në mur, duke rrahur krahët, sapo të ndalet mbi gardh apo mbi mur dhe fill pas rrahjes së krahëvet, ia thotë këngës. Nëpër pyll dëgjohen cicërima zogjsh të llojllojshëm dhe cicërimat e tyre e mundin kukamën e qyqes. Dhe ashtu, duke dalë prej natës së vdekur, çdo gjë e ka përfshirë mëngjei i gëzueshëm, plot dëshirë për të punuar. Këtyre gjallesave të kujdesshme, shtëpiake apo të egra, mbuluar rrezesh të arta të Diellit, u janë bashkuar, gjithashtu të kujdesshëm, fshatarët e gëzuar. Fëmijët dhe graria përcjellin lopët në kullosë, mjelin dhentë, shkojnë për ujë dhe përgjithësisht kryejnë punët e mëngjesit. Meshkujt e fuqishëm dhe të përkorë, të nxehur prej punet, ngjiten dhe zbresin pa pushim të përpjetën e lëmit, duke i shpejtuar hapat nën peshën e rëndë të thekrës. Tash për tash nuk mund t'i numërojmë, sepse asnjëherë nuk janë bashkë, as në lëmë, ku e sjellin thekrën, as në arë, ku e marrin thekrën. Ata përpiqen që sa më parë ta bartin atë dhurtatë të Zotit dhe ta nxjerrin nga humnera, gjë që duket sikur po e nxjerrin prej barkut të anijes. Dhe, vetëm kur njeriu e përfytyron sa rëndojnë 50 dorëza

thekër kur i vë mbi kurriz, i gufohet fryma, le më kur atë barrë e mban vërtet. Mirëpo ata janë diva, diva të vërtetë të pamposhtshëm, të cilët, edhe qytetarit më të guximshëm, mund t'ia shkrepin mu nën hundë: *“Ore cofëtinë! Argëtimi yt kryesor është të kalbesh sipër femrës dhe më në fund edhe të vdesësh sipër saj. Ndërsa politika jote më e dashur, të talleh me fshatarët e ndershëm.”*

Dhe shih si u rrjedh djersa nëpër faqet plot me buzëqeshje të ngrohtë, dhe si, me gojë gjërësisht të hapur, thithin ajrin e freskët të malit. Disa rrëshqasin shpejtas tatëpjetë bregut, duke fshirë djersët në ballë, dhe duke u hedhur ndonjë fjalë atyre që shtyhen përpjetë nën peshën e rëndë. *„Besa, është zor të mbahen 10 stogje.“* *„Unë, dikur, si hiçgjë i kam mbajtur 11, kurse tash, mezi i mbaj 8.“* *„Sa herë bajte ti, Maco?”* Dhe kështu, secili thotë diçka në lidhje me atë punë, ndërsa maja e barrës lëkundet si një sustë elastike.

Mund të kuptohet tashmë nga biseda se sili ka thirrur sot për ndihmë, pra, thekra e kujt do të shihet sot. *„Apo s'kemi për të hangër sot mish të pjekur!”* Edhe kjo do të ishte njëra prej fjalive, hedhur njëri-tjetrit kalimthi, prej së cilës merret vesh që Mac Pera, fshatari që e ka thirrur sot ndihmën, është edhe në gjendje të mirë.

Tashmë mund edhe ta përfytyrojmë pamjen e drekës në lëmin e Macit. Së pari, si meze rakie, herishtet, të thollura prej miellit të shtëpisë, zier me qumësht, pastaj mëlçi bagëtie, plënc, zorrë dhe përgjithësisht të brendshmet e deles, përgatitur me dhjamë të bollshëm. Pastaj vjen mish sade (Ashtu është tradita në Shastan). Mbas mishit, ëmbëlsirë ose herishte përvëlur me vaj, ushunj ose mazë. E tash, pas gjithë këtyre, vjen ai mish i që u përmend pak parë, i cili s'është tjetër, veçse mish i pjekur mes shumë patatevet, të ndara më dysh.

Lundërtari i famshëm,/ Kristifor Kolombi i lashtë,/ na e zbuloi Botën e Re,/ që sot po na rri mbi krye, e ashpër dhe e vrazhdtë.

(Vargje, shkruar shqip me shkronja cirilike. Gj.D.2015) More lule fort e dashtun,/ Mos e lno zemrën e çartun/ Mos rri illt, o djal i ri/ Se po shkon n asqeri/ nuk po munj me shku n ushtri/ Pa ta lan një porosi/ Dije mir se t'kam besuo/ E gjiçka t'kam bjeseduo/ Kena fol gjiçka zaman'/ Npër goj mirrnjim gjill dynjan/ Por mas vaktit po kajatem/ ato fjal mos t'na përhapen / Pej kti venit kur t'largohem/ E di mir se

tash harrohem/ Do ma t'ri qi jan n'katun/ tash bahen ma t'mir se un/ Men'ja vajzs
asht fort e let/ Djelt e ri qi shkojn n'asqer/ Nje kët pun ta ken nër men.//

(Plan për një krijim letrar. Sllavist. Gj.D.2015) Fillimi: Porosi të dashurës së vet, se çfarë mund
të ndodhë, kur ai të shkojë në ushtri.

Gjysma e dytë: Vërejtje nga poeti drejtuar njerëzvet të rinj dhe rekrutëvet.

(Vargje, shkruar shqip me shkronja cirilike. Gj.D.2015) Kur nxehen me muhabet/ Nje kta djelm
qi rriten sot/ Pej sish ke me u ruajt fort/ Nja do qi vin' pej asqerit/ Mir ja mushin
menen njerit/ Shum zoret i kan kaluo/ Mir me rrejt atje jan suo.//

(Vargje sllavisht. Gj.D.2015) O nënë, o nënë/ Sa fort të dua/ Se më ke mëkëmbur, nënë,/
Duarthatë// Aty shihet, o nënë/ Dashuri e pastër/ Kur për mua e gjen ushqimin/ e
për vete s'ke asgjë.//

Nga 25 qershori deri në 15 gusht kam bërë pauzë, nuk e kam shkruar ditarin, nga
nënvleftësimi, por edhe nga të mbingarkuarit me punë.

Nga 15 gushti po filloj ta shkruaj ditarin.

E hënë, 15.VIII.1955.

Çohem heret dhe nisem për në Dobrovodë, në festë te Lena. Është Dita e Shën
Mërisë. Atje kalova shumë mirë. Më pritën mirë. Drekën e hëngra te Lena, kurse
darkën te Kola, axha i burrit të saj. Gjithë mbasditën e kaluam me shaka e të
qeshura, në shoqëri të mirë. Para darkës kemi kënduar ndenjor dhe kemi kërcyer
malazezçe, ndonëse ishim pak njerëz.

E martë, 16.VIII.1955.

Në mëngjes u zgjova vonë. Gjithë paraditën e kaluam në të njëjtën shoqëri si dhe
dje. Hëngrëm drekë dhe u nisëm drejt Ulqinit, bashkë me 2 kunetët e Lenës,
Antonin dhe Pjetrin. Na zuri shiu dhe u lagëm pak. Para mbrëmjes mbërrita te daja
dhe i tera petkat, pastaj u nisa në festën e Shënepremtes te halla Mrikë. Kalova
mirë në mbrëmje. Kishte shumë miq. Fola gjatë me një marinar, mysafir edhe ai,
dhe u njoha me punën e tyre.

E mërkurë, 17.VIII.1955.

Deri në darkë e kalova në shetitje te fqinjët e hallës Mrikë. Shkova të vizitoj Zef Gjokën, që është sëmurë. Pasdite shkova në Ulqin te daja Gjon. Biseda kryesore qe rreth qëllimit tim për të blerë një mushkë, gjegjësisht, si t'i siguroj të hollat e nevojshme. Në Ulqin ka bostan me shumicë, nga 10 dinarë kilogrami.

E enjte, 18.VIII.1955.

Në mëngjes shëtita nëpër qytet dhe u takova me shumë shokë të shkollës, që s'i kisha parë prej kohësh. Në orën 1 pasdite udhëtova me anije për në Tivar. Deti ishte i qetë dhe udhëtimi i këndshëm. Nga Tivari, ku arrita pas 1 ore, u nisa më këmbë për në Shestan, ku mbërrita pasi ishte errur.

E premte, 19.VIII.1955.

Në mëngjes nisem nga Gurrza për në Murrize (kasolle dhe rrathinë në mal, në Funbrinjë), ku i mbajmë dhentë (në verë e vjeshtë). Gjithë ditën ruajta dhentë, kurse në mbrëmje fjeta pranë tyre në kasolle.

E shtunë, 20.VIII.1955.

Çohem heret, i mjel dhentë dhe i nis në mal. Në mesditë ia dorëzova Simës së vogël (kushëririt tim) që t'i ruajë, kurse unë shkova te kasollja, ku po shinim thekrën unë edhe tata. Vazhduan orë të trishtueshme, për të cilat e pranoj se jam unë fajtori, sepse përherë nervozohem për shkak të ngathtësisë së tatës në punë. Veç kësaj, tata shpesh gjatë punës më poshtëron, e unë poshtërimin nuk mund ta duroj, madje as prej prindit.

E dielë, 21.VIII.1955.

U çova heret, mola dhentë dhe i lëshova në mal. Gjithë ditën ruajta dhentë. Në mbrëmje zbrita në fshat. Nga 15 deri më 21 ka qenë kryesisht mot i mirë me ndonjë re të vogël, përveç datës 18, kur ra shi për rrëth 2 orë.

E hënë, 22.VIII.1955.

U çova heret dhe u ngjita në Murrize për të lëshuar dhentë. Ruajta dhentë gjithë ditën. Në mbrëmje fjeta pranë tyre. Një dele më ka humbur. Po shkruaj një këngë me titull "*Shestanas*".

E martë, 23.VIII.1955.

Qe mot i mirë. Unë ruajta dhentë. Në të njëjtën kohë kam çarë pallazina për të bërë një rrethim. Në mbrëmje zbrita në shtëpi, në Gurrzë. Aty pat vërshenicë dhe luajtëm e kënduam deri vonë.

E mërkurë, 24.VIII.1955.

U çova heret dhe shkova në Murrize, për të lëshuar dhentë. Gjithë ditën ruajta dhentë. Qe mot i mirë. Në mbrëmje fjeta pranë dhenvet.

E enjte, 25.VIII.1955.

Qe mot i mirë. Unë ruajta dhentë dhe në mbrëmje fjeta pranë tyre në Murrize.

E premte, 26.VIII.1955.

Mot i mirë, por duke u vrënjtur. Unë ruajta dhentë. Në mbrëmje fjeta pranë tyre. Sot ka ndodhur në Shestan një fatkeqësi. Vukë Nika Vukmarković, shkak i një grindjeje, ka qëlluar Gjon Palë Marvuçiqin dhe e ka plagosur në 3 vende: në sy, në kofshë dhe në dorë, por ai i ka shpëtuar dhe është fshehur në shtëpinë e Nikë Vuçë Nrekovićit, kurse vrasësi ka vrapuar rrugës dhe, duke menduar se është Gjon Pala, ka varur Gjon Luc Stankovićin dhe ka ikur.

E shtunë, 27.VIII.1955.

Ndaj të gdhirë dëgjova një zhurmë. Ishin njerëzit që mbanin Gjon Marvuçiqin, për ta çuar te mjeku. Sot bëhet edhe varrimi i Gjon Stankovićit. Secili ndien dhimbje sot, me gjithë shpirt, për ata 2 njerëz.

Moti qe i mirë. Unë ruajta dhentë.

E dielë, 28.VIII.1955.

Në mëngjes u çova heret dhe po bëhesha gati t'i lëshoja dhentë, kur erdhi tata prej Gurrzet dhe më nisi në shtëpi. Gjithë ditën ndenja shtrirë, nuk shkova as për të luajtur futboll, as te ndonjë shok, sepse sot krejt Shestani është i shqetësuar dhe i trishtuar për shkak të asaj vrasjeje.

E hënë, 29.VIII.1955.

Në mëngjes u çova heret. Qe mot i mirë. Gjithë ditën kam punuar rreth do tullarëvet të nënës: Bashkova pjesët e tyre, kurse ato që mungonin i bëra të reja. Në mbrëmje po fle te dhentë në mal. As të axhës nuk janë këtu asnjë. Shkaku i asaj ngjarjeje, kam frikë se mos më vjen ai vrasësi për të më marrë gjë me zor.

E martë, 30.VIII.1955.

Qe mot i mirë. Ruajta dhentë. Në mbrëmje po flë pranë tyre.

(Vargje shqip, me shkronja cirilike.Gj.D.2015) T'gjill nigonjin shokt e ti/ Pa kujdes as pa çudi/
Se ata përtta kan arll/ Preçit nusen për me i marr/.

E shtunë, 3.IX.1955.

Moti gjysmë i kthjellët. Unë ruajta dhentë. Kam sjellë edhe 9 qingja nga Gurrza. E kam vështirë që t'i ruaj, sepse qingjat ndahen nga tufa dhe rrinë vetëm. Në mbrëmje fjeta pranë tyre. Gjatë natës gdhenda për sqeparin një bisht prej ahu. Kam prerë edhe një dorëz parmende prej frashëri.

E dielë, 4.IX.1955.

U çova në mëngjes dhe i mola dhentë. I lëshova dhe i nisa drejt Kronjezavet, që t'u jap ujë. Në mesditë ia lashë Lucit të axhës dhe u nisa për në Togjemil, për të prurë fiq edhe rrush. Në mbrëmje arrita në Gurrzë.

(Vargje shqip, me shkronja cirilike. Gj.D.2015) Me vajz' ishin bjeseduo/ N'Tivar Posht me u bashkuo/

E hënë, 5.IX.1955.

Në mëngjes u ngjita në Murrize, për të lëshuar dhentë. Më mbetën 5 qingja jashtë, nuk pata kohë të shkoj e t'i marr, sepse mendoja të zbrisja në Gurrzë. Në mbrëmje fjeta në Gurrzë. Sot ka qenë mot i mirë.

E martë, 6.IX.1955.

Sot është mot i mirë. Ndenja në shtëpi, sepse Pala po fillon të shkojë në shkollë dhe duhet ta çoj unë dhe ta regjistroj. Shkova me të në shkollë dhe me kaq filloi shkollimi i tij. Është 6 vjeç e 3 muajsh. Mbasdite ngjitem në Murrize. Nëna s' i kish gjetur ata 5 qingja.

E mërkurë, 7.IX.1955.


Sot ruajta dhentë, nëna kërkoi qingjat. 2 na i gjeti Osmani i Alushit prej Rjepsit, 3 të tjerët mbetën prapë jashtë. Në mbrëmje fjeta në Gurrzë.

E enjte, 8.IX.1955.

Përcolla Palën në shkollë dhe u nisa për në Murrize. I gjeta edhe 3 qingjat. Në mbrëmje zbrita në Togjemil, për t' i çuar një qingj Mujovicës, që ta therë ditën e lëmit. Fjeta te Ramoja i Zekos.

E premte, 9.IX.1955.

Çohem heret dhe vjel fiq e rrush. Nisem për Murrize. Arrita vonë dhe i lëshova dhentë. Qe mot i mirë.



E shtunë, 10.IX.1955.

Paradite mot i mirë, mbasdite vrënjtur. Në mbrëmje ra shi i madh. Unë deri tash nuk mbaj mend një të tillë shi. Ruajta dhentë. Në mbrëmje fjeta pranë tyre dhe i rrahu shiu gjithë natën. Hyri ujët në kasolle dhe e mbushi deri në gju. Zjarrin ma fiku uji. U detyrova të kaloj te kasollja e axhës. Atje, nusja e axhës e kish zjarrin të ndezur.

E dielë, 11.IX.1955.

Në mëngjes i lëshova dhentë, por erdhi tata të më zëvendësojë. Në fillim erdha te kasollja dhe pastrova baltën që e kish krijuar shiu i mbrëmshëm. Mbasdite zbrita në Gurrzë dhe erdhi te unë Kola i Macit Gjok's Per's. Brodhëm gjithë kohën për arra e për rrush. Moti që në shi.

E hënë, 12.IX.1955.

Sot po përgatitem për në Tivar. Në mëngjes arnova opingat, pastaj mora 4-5 kilogramë djathë dhe u nisa. Tregtia nuk më shkoi mirë. Isha qejfprishur. Në kthim u ndodha në shoqëri të mirë, me 2 femra dhe me kushëririn tim Markun. Udhëtuam gëzueshëm duke bërë shaka. Në mbrëmje ndenjëm te Pjetër Perçobiqi. Shaka kish plot, por disa prej tyre të papërshtatshme për mua.

 (Vargje shqip me shkrim cirilik. Gj.D.2015) (Shënim i veçantë: Për të mos krijuar keqkuptime, e pashë të nevojshme t'i ndryshoj emrat e personazhevet. Gj.D.2015)

Bjesedon robi me rob/ Bjesedon zogu me zog/ Bjesedon gjethi me bar/ Çka ka ba
 një zadrugar/ Bjesedon qarri me lis/ Për një vajz qi kan grabit/ Me e grabit ka met
 një fjal/ Por ata grabit s'e kan/ N'mehan vasha vet ka arll/ Nji ke men djalo me
 m'marr/ Sante nata na ka arll/ Ky ish Preçi me shok t'ti/ Te pi birr, te pi raki/ Me
 Mac Lekën djali të ri/ Xhemal Kasmin kavgaxhi/ Muj Lekiqin, Selim Gjetin/ Për
 Preçin qi napin vetin/ Se ç'ka vojt vasha i ka than/ Nër sy t'shokve në mehan/ Prij
 djalo o n mal o n shpi/ N shpell një shkosh, un vinj me ty/ Se at djali qi m kan fejuo/
 Un me zemër nuk e duo/ S'e duo as z'du me marr/ Ku t shkosh ti un du me arll/ Se
 ç'ka qitë Preçi ka than/ Nër sy t'gjillve në mehan/ Ti di vash se ç'e kur t duo/ Çe
 t'kam lut për me u fejuo/ Kur kam pa se nuk t'kan llan/ Jam larguo e t'kam lan/ Me
 gjill se un jam larguo/ Zemra jeme s'të ka harruo/ Kam lyp vajza një e dy/ S'i kam
 dash asnjë si ty/ I kam lyp e jam larguo/ Daj ka dal diç me m'ngatrruo/ Ata elle një
 m'kan dash/ Me u feju' s'ka kjen nafak/ Se nafaka ty t'ka prit/ N'mehan sante me
 t'grabit/ T'gjill nigonjin shokt e ti/ Pa kujdes as pa çudi/ Se ata për ta kan arll/
 Preçit nusen për me i marrë/ Me vajz ishin bjeseduo/ N'Tivar Posht me u bashkuo/
 Si kan than ashtu ka dal/ N'Tivar Posht vasha ka arll/ U çuon do krushqatarë/ Pej
 Hanit Shestan me arll/ Nji tub krushq shoqni e mir/ Qi s'shkon n'dazëm për m'u
 nginj/ qi s'shkon n'dazëm me mush barkun/ Por një u lypt me derll lle gjakun/ Dal
 kadal përpjet jan nis/ N'vakt t'darkve Shestan kan mrrit/ Por a do ti mrekuilli/ Tata
 djalin s'e le n'shpi/ Nuk e duo un at shak/ Me m arll natën pa bajrak/ Nuk e duo at
 rrospi/ Qi ikën mas djelmve ri/ Qi rzigon rrugat me kap/ Pa bvet nan as pa bvet
 tat/ Xhemal Kasmi po i del para/ Mos ne ban ata Zef Lala/ Mos ashtu Zefa he burr/
 Se kjo pun nuk ka kjen kurr/ Dynjaja gjaqet po falin/ Jo tata s'po falen djalin/ Se
 sot vakti kshtu ka arll/ Cillën t'duojsh, at me marr/ Sot s'shigohet ku t'thon gjin'ja/

Nër gjin t'pasun e zenjina/ Ku t' bahen dy zemra bashkë/ Nuk po bvesin nan e tat/
Gati Zefi pat burrni/ Le t'vinje tha sante n'shpi/ Por e ama zemërgur/ S'e la mren,
tha, kurr as kurr/ S'e duo at kore shpi/ Djaln n'sherr qi ma ka shti/

(Shkrim në gjuhën sllave, Gj.D.2015)

PROBLEME TË SPITALIT TË TIVARIT

Spitali është i mirë,

Por populli i keq.

Sepse nuk ka pare,

ai duhet të vdesë.

Populli i Tivarit dhe rrethinës e vajton vërtet me të drejtë të ndjerin Dr.Miodrag Jovanoviçin, sepse, që kur ai u vra, ky institucion ka mbetur si një kope pa bari. Ai vrasës tinar nuk ka vrarë vetëm një njeri, por ka vënë në rrezik jetët e shumë njerëzve të këtij mjedisi, i cili ka shpresuar shumë te ky spital.

Jovanoviçi ia ka pasë rrëmbyer vdekjes shumë njerëz. Shumë njerëz i pat kthyer midis nesh. Po tash, ç'të bëjmë? Ai është vrarë. Atë populli s'pat mundësi ta kthente, s'pat mundësi ta mjekonte. Në të vërtetë, ai nuk u vra tani. Ai është vrarë para 2 vjetësh, por mungesa e tij po ndjehet gjithnjë e më shumë. (Kjo po ndodh sidomos me ata pacientë që nuk e njohin gjuhën sërbe.)

Vetëm prania e tij, vetëm zëri i tij, e kthjellonte edhe të sëmurin më të rëndë. Dhe vetëm pamja e tij, dhe vetëm mendimi se ai ndodhej aty, i jepte personelit nxitje për punë dhe për t'u kujdesur për të sëmurët. Dhe, në rast se cilido i shtruar do të tentonte për të prishur qetësinë në dhomë apo nëpër korridore, të tjerët do ta përkujtonin: “Do të të shohë drejtori!” Dhe kaq do të ishte e mjaftueshme që të riktheheshin rregull dhe qetësia e domosdoshme.

Kur ai bënte vizita, edhe të sëmurit rëndë i kthehej buzëqeshja. Jetonte midis shqiptarëvet, nuk e dinte shqipen, megjithatë, merrej vesh mirë me ta. Brenda tij bujiste dashuria ndaj njeriut dhe, qoftë shqiptar, qoftë malazias, mashkull apo femër, i varfër a i pasur, fshatar apo punëtor, primitiv apo i kulturuar, për të ishte krejt njësoj dhe ndaj secilit tregonte të njëjtin kujdes.

Por tash s'është ashtu. Ai është vrarë. Spitali ka mbetur pa një dorë të fortë. Drejtoreshë spitali tash është bërë bashkëshortja e tij. Edhe ajo është kirurge, siç ka qenë edhe i shoqi. Edhe ajo ka aftësi të shumta si mjeke. Por ajo s'është ai. Ajo

nuk i ka sytë e tij xixëllues, zërin e tij, nuk e ka të qeshirën e tij brohoritëse. Edhe diç tjetër: ajo është tepër nervoze.

Mjekët e rinj, që punojnë në këtë spital, shohin më shumë rehatinë vetjake, sesa detyrën. Ka të sëmurë që shtrohen në spital medemek për t'u shëruar, por nuk u bëhen analizat për 5 apo 6 ditë. E ndodh edhe ashtu që të sëmurin e pyesin te shtëpia, cili mjek e ka mjekuar, e ai u përgjigjet, se rrallë ka parë mjekë aty, le më t'ua mbajë mend emrat.

Gjithë kujdesi për të sëmurët është lënë në dorën e motravet murgesha dhe duhet thënë që shumë njerëz, kur dalin prej spitalit, thonë me zë të ulët: „*Të mos ishin murgeshat, nuk do të quhej spital, por stallë.*“ Dhe vërtet, ato janë më të afërtat me të sëmurët. Ato i duan të sëmurët dhe të sëmurët i duan ato, si të ishin motra prej një nëne.

Mjekët kujdestarë natën nuk kalojnë fare nëpër dhomat e të sëmurëvet. Kam qenë vetë i shtruar, kur në dhomën time patën sjellë një plak të sëmurë rëndë dhe, vetëm pasi kam intervenuar 3 herë, mezi ka ardhur mjeku dezurn dhe, duke shijuar ëmbëlsinë e gjumit, ia ka dhënë plakut disa tableta. Kurse plaku, edhe pas kësaj, ka vazhduar t'i "nanurisë" të sëmurët e tjerë, deri në mëngjes, me rënkimet e tij. Të këtillë raste janë të shumtë.

Kjo që parashtrova deri këtu, vlen vetëm për ata të sëmurë që arrijnë të shtrohen në spital. Por ka edhe një hall tjetër, i cili, me thënë të drejtën, nuk haset vetëm këtu. Kjo edhe i rëndon më së shumti banorët e varfër të kësaj ane. Pagesa e spitalit është tepër e shtrenjtë: paguhen 1000 dinarë në ditë.

E tash le ta mendojë vetë secili mendimtar i lirë. Mendojeni mirë e bukur, ju lutem! Në qoftë se sëmuret një pjesëtar i një familjeje, e cila, siç ndodh më së shumti në këto anë, nuk ka më shumë se 40 deri 50 mijë dinarë të ardhura në vit dhe i duhet mjekim më i gjatë se 1 muaj. Ç'i mbetet asaj familjeje për pjesëtarët e tjerë?! Ç'i mbetet atij për 11 muajt e tjerë, të cilët ndoshta i duhet t'i kalojë pa punuar? Asgjë! Bash asgjë nuk i mbetet! Ka pak tokë dhe edhe atë detyrohet ta shesë për t'u mjekuar. Ndoshta edhe nuk shtërngohet ta shesë atë pak pasuri të patundshme, por gjithsesi, në do që të shërohet, është i detyruar të shesë diçka nga pasuria e tij modeste. Ose mbetet pa u shtruar në spital.

Popullit kështu i ka mbetur vetëm mundësia e mjekimit në shtëpi, në kushte tepër të vështirë, me ndihmën e ilaçeve, të cilët, sidomos kohët e fundit, janë shtrenjtuar shumë.

Privatët e kanë vërtet vështirë. Kjo duhet pranuar pa tjetër. Ndërkaq, punëtorët dhe nëpunësit nuk paguajnë asgjë prej asaj që u vjen në xhep.

Me këtë rast, e quaj të nevojshme të tërheq vëmendjen edhe në një tjetër çështje. Është çështja e vizitave të të sëmurëve të pasiguruar, të cilët, e them lirisht, as që mund të vizitohen nëpër ambulanca. Atje punohet me njëfarë rregulli, ku thirren emrat me anë të librezave të punës. Në atë mënyrë, privatët, që nuk kanë kurrfarë libeze, mbeten krejt anash. Ekzistojnë edhe ambulancat private, por atje çdo vizitë kushton 300 dinarë.

Unë e di që ata, pra, punëtorët dhe nëpunësit, e kanë sigurimin social dhe e kuptoj shumë mirë ç'është siguri social, mirëpo, as fshatari nuk është tepriçë në shoqërinë socialiste. Edhe ai i duhet shoqërisë.

(Plan, me sa duket, i një poeme, shkruar shqip, me shkronja cirilike. Gj.D.2015)

1. Arllja jeme n Tivar e t njitunit n Shestan.

2. Banimi i jem n Shestan.

1.a) Çka parakujtohesha për vendin tem n cillin nuk kam kjen kurr.

b) Çka pash n Tivar.

c) Si u njita ka Shkalla e Barll e me çfar kujdesit.

2.a) T arllunit n Shestan.

b) Çka vuna re ma t parën her.

c) Punimi i tyne.

d) Hadetet n xhdo ven qi gjinen.


e) Dyzenet e shestanasve.

1. a) N zemër kishesh marak t mall
 Me ulltuo për Shestan
 Me ulltuo për një ven
 N cillin kurr nuk kishesh kjen
 Ku banojn kushrinjt e mi
 Punojn tok, ruojn bakti
 O i ngrati bab e nan
 Si e lat ju vendin ton
 Pse shkuot ju me fituo
 N lle t huoj gjillmon
 me rrnuo
 Çfar lumnijet patët dishruo
 Prej Shqypnijet me u larguo
 Kini shkua larg n Turki
 Npër lokanta hyzmetçi
 N Stamboll u bat garsona
 Dlirsa t kqi npr
 sallona
 Zotnive u shinjit kundrat
 Prej petkash u dlinnjit trunjat
 Shum moti u shkonte bosh/

1.a)N zemër kishesh marak t mall/ Me ulltuo për Shestan/ Me ulltuo për një ven/ N cillin kurr nuk kishesh kjen/ Ku banojn kushrinjt e mi/ Punojn tok, ruojn bakti/ O i ngrati bab e nan/ Si e lat ju vendin ton/ Pse shkuot ju me fituo/ N lle t huoj gjillmon me rrnuo/ Çfar lumnijet patët dishruo/ Prej Shqypnijet me u larguo/ Kini shkua larg n Turki/ Npër lokanta hyzmetçi/ N Stamboll u bat garsona/ Dlirsa t kqi npr sallona/ Zotnive u shinjit kundrat/ Prej petkash u dlinnjit trunjat/ Shum moti u shkonte bosh/


Dita u rrinte trillet grosh/ Pesmllet lira mirrnjit n muoj/
 Ata ishin buka juoj/ Për he
 tuoj ç'me menuo/ Prej tepricash kini rrnuo/
 Zotnivet çka u ka tepruo/ Copa buket
 hena t çartna/ Ini nginj me supna t tharta/
 O shqyptar, vllazënt e mi/
 Lini t'huojt ktheni n shpi/
 Nuk u duhet gja Turkija/
 Si ashtu lle Italiija/
 Amerika, Ingliterra/
 N llene t huoj çilin ferra/
 N llene t'huoj s'ka lumni/
 S'ka dashni as pasuni/
 Mos t'ju rrenje parja e shkret/
 Se ma i mir asht veni i vet/
 Ma mir kane zbat e zhvish/

Dita u rrinte trillet grosh/ Pesmllet lira mirrnjit n muoj/ Ata ishin buka juoj/ Për he
 tuoj ç'me menuo/ Prej tepricash kini rrnuo/ Zotnivet çka u ka tepruo/ Copa buket
 hena t çartna/ Ini nginj me supna t tharta/ O shqyptar, vllazënt e mi/ Lini t'huojt
 ktheni n shpi/ Nuk u duhet gja Turkija/ Si ashtu lle Italiija/ Amerika, Ingliterra/ N
 llene t huoj çilin ferra/ N llene t'huoj s'ka lumni/ S'ka dashni as pasuni/ Mos t'ju
 rrenje parja e shkret/ Se ma i mir asht veni i vet/ Ma mir kane zbat e zhvish/



Se n ven t'huoj n'ar me u vish/

1.b)Nuk di kush sa fort po gzohem/ Se shqiptarve po u afrohem/ Erll vaporri n Va t
Tivarit/ Vuna kamën n lle t'shqiptarit/ T parën her syni m'shikonte/ Shum popullin
qi punonte/ Gjill me krampa n'gur punonjin/ Naj Tivar një breg rrenonjin/ Kqyr
shqyptart zhvillojn qytetin/ Me gur malit mushin detin/ Dinjesh shqyp me
bjeseduo/ Çe thmi nana m'kishte suo/ Ju avita një puntorit/ Le ta di se shqyptar
jam/ Le ta di se ç'emën kam/ E i fola pa pik zorit/



Puna mar vllazën shqiptar/ Ata i folën nja do fjal/ Qi nuk mujta vesht me i marr/
 N'mjedis t'zemërs m'u çil varra/ Vara kryet shkova t para/ Me kofer nën dor te
 shkuo/ T para sysh m'doli një gruo/ Fort çuditshim e shikova/ Petku i saj ish barll si
 bora/ N'parzma kish gjylpan me ar/ N'krye vu një jashmak t'barll/ Boçe t'kuqe por
 si gjaku/ Shami t'verll por si zamaku/ Çysh puntorsh un u frigova/ Me një'za
 t'marrshim ksj i fola/ Prej ka je ti more zoj/ Popllit tan, thaç, si t'i thojn/ Ater kjo
 filloi me u qesh/ Nuk jam zoj por çobanesh/

Kam arll kane djath me shit/
 Veni i jem asht larg nji dit/
 Venit tem Shestan i thon/
 N'çobani vakti na shkon/

Kam arll kane djath me shit/ Veni i jem asht larg nji dit/ Venit tem Shestan i thon/
 N'çobani vakti na shkon/

(Vargje shkruar sllavisht. Edhe këtu u ndërrua emri i personazhit, për të mos krijuar keqkuptime, dhe shqipërimi u bë krejt i lirë. Gj.D.2015) Gjokpaloviq Preçi, djalë i ri/ Rrëmbe çikë e ço në shpi/ Rrëmben çikën të fejuar/ Gjith‘ Shestani u trazua/ Prej Zalefit, vend rahatit/ Te Shestani, malethati/ Te Shestani, kodra, brigje/ Te Frashniqi, gurë e shtigje/ Gjith‘ Tivari bën çudi/ Trill i femrës, dashuri/ Dashuria, lot limoni/ Preçin deshi, Preçin mori/ Si i thonë fjalës, gjer në vdekje/ Çikë e re, një çikë Zalefje/

(Shënime shqip, me shkronja cirike, për dhentë që mbarsen dhe, përafërsisht, ditët e pjelljevet. Gj.D.2015) Nji shijevic kapure e Ramos, 7.IX.1955 – 5.II.1956. E bija e Kapures ton, 7.IX.1955 – 5.II.1956. Gala e Egër, 8.IX.1955 – 6.II.1956. Baca e Malle, 10.IX.1955 – 8.II.1956. Nji shijevic shar e Ramos, 11.IX.1955 – 9.II.1956. Shara e Vogël e Shoqes Mujos, 11.IX.1955 – 9.II.1956. Lakuqja jon pej Shoqes Mujos, 12.IX.1955 – 10.II.1956. Shara e Malle e Shoqes Mujos, 13.IX.1955 – 11.II.1956. Shara jon (e bija e Shar’s Vogël), 14.IX.1955 – 12.II.1956. Shara Pikaloze e Ramos, 17.IX.1955 – 15.II.1956. Syka e Malle e Ramos, 17.IX.1955 – 15.II.1956. Nji shijevic harapesh e Ramos, 17.IX.1955 – 15.II.1956. Lakuqja e Malle e jona, 17.IX.1955 – 15.II.1956. Gala e G’jat, 18.IX.1955 – 16.II.1956. E bija e Gal’s G’jat, 18.IX.1955 – 16.II.1956. Gala Rrumullake, 18.IX.1955 – 16.II.1956. Gala e Zez Fort, e Ramos, 18.IX.1955 – 16.II.1956. Gala Thinjoçe, 20.IX.1955 – 18.II.1956. Baca e Bukër, 20.IX.1955 – 18.II.1956.

(Vargje shqip, me shkronja latine. Gj.D.2015) Nji dit vere natje here/ Çobanesh shkova me dele/ Kur dola na mal t maler/ Ma knaqi shpirtin kjo er/.

(Vargje shqip, me shkronja cirilike. Gj.D.2015) E t’u kapën masha mash/ Njani tjetrin kap e plas/.

(Vargje sllavisht, shqipërim i lirë. Gj.D.2015) Demoni, veç vrapo, kërce/ Tund çomag‘ e brekët ngre/.

KAPITULL SQARUES

Lënda që e përktheva këtu dhe ajo e shkruar shqip me shkronja cirilike (Në shekullin XX, kur liria e kombevet dhe progresi social servireshin me bollëk!), është përgjithësisht e kuptueshme. Njeriu që do ta lexonte këtë lëndë, edhe po të kisha vdekur unë, do të mund të nxirte konkluzionet që do t'i duheshin. Mirëpo, deri sa jam gjallë, për ta lehtësuar edhe më të kuptuarit e kësaj cope jete, tashmë aq e largët, sa edhe vetë unë shumë hollësi i kam harruar, mendova t'i bëj disa sqarime .

Nuk besoj të mërzhiten, ata që janë të interesuar.

2.I. „*P.N.P.*“ S'e kam fare idenë se kush ishte. Ndonëse përemri (*neke*) e tregon femër, ai mund të ketë qenë fare mirë ndonjë djalë, me të cilin mund të kem pasur ngatërime.

3.I. „*2 dhen më kanë mbetur në mal*“. Ky taksirat i imi do të përsëritet shumë herë gjatë këtij viti. Mali i Krythës është i mbushur me lloje drurësh që rrinë gjithë dimrit të gjelbër. Krishë(mretë), qarrucë, ilqë, dëllinjë, mare, dhe që të gjitha janë shkurre, kështu që, mund ta kesh delen 10 m larg, mund t'i kalosh pranë 20 herë, e të mos e shohësh.

3.I. „*Luajtëm letra*“. Loja jonë kryesore ishte *skamili*. Mund ta luanin, 2, 4 ose 6 vetë. Kur ishin 4, bëheshin 2 e 2, kur ishin 6, bëheshin 3 e 3, të ulur, 1 po, 1 jo, pra të alternuar me grupin kundërshtar. Ish lojë jashtzakonisht argëtuese. Nuk luhej me të holla. Për secilën letër kish shenja të veçanta që, për t'ia treguar shokut, improvizoheshin me pjesë të fytyrës: me lëvizje hundë, me mbyllje të 1 syri, me mbyllje të 2 syve, me zgjatje buzësh, me ngritje vetullash, me nxjerrje gjuhe... Fitorja e njërës apo tjetrës palë shprehej me brohoritje. Ndërkohë, gratë e vajzat bënin punë dore dhe, herë-herë, ndiqnin edhe lojën.

5.I. „*Gosta e gurriqit*“ ose „*gosta e gurriqavet*“. Festë e veçantë, traditë, me sa duket, shekullore, ndër të krishterët e Shestani, katolikë e ortodoksë. Çdo familje mbante zakonisht 2 thi (2 derra), që Shetani, duke përgjithësuar edhe mashkullin, edhe femrën, edhe më të voglin, edhe më të rriturin, i quan *gurriqa*. Në fund të vjeshtës gurriqat vriteshin. Shestani, në vend të foljes *me therë*, përdor foljen *me vra*, sepse gurriqi goditet në ballë me mykën e sëpatës. Gostën e gurriqit apo gurriqavet e bënte çdo familje dhe ushqimi kryesor ishte fërgica: mëlçi (që Shestani i thotë *pikat*), mushkëri, veshka, shpretkë, copëra dhjami (që Shestani i thotë *ushunj*), gjëndrra, por edhe copa mishi, të kuq (pjesë muskujsh) e të bardhë (lardo), përgatitur me një mjeshtri të veçantë, me qepë ose, ndër shestanasit e rrethinave të Ulqinit, edhe me presh.

9.I. Mbas meshes shkoj te shkolla, për të dëgjuar një ligjëratë “*Mbi të drejtat e njeriut*”. Është fjala për “*të famshmin*” dokument të OKB-së, për të cilin unë, pikërisht sivjet, 2015, kam bërë një analizë të thukët DEMASKUESE.

11.I. “*Me ndenjë*”, me kalue te dikush një pjesë të mbrëmjes mbas darkësh. Shestanasit thonë: “*Po shkojmë me nenjë*”, “*Ku kini nenjë mramë?*” “*Ku po rrimë sante?*” Malazezët i thonë *sjednik*, të ndenjtur, ndenjje. Në Shestan, kjo formë tubimi praktikohet pothuaj çdo natë, sidomos gjatë dimrit, dhe është e krahasueshme me institucionin e *ODËS*, *ndeja* të mirënjohura gjithandej ndër shqiptarët. Vetëm se, Shestani, nuk i ndante, burrat më vete e gratë më vete, gjë që dëshmon një traditë iliro-arbërore, paraosmane.

11.I. “*Osman Kordiqi*”. Në të vërtetë, ishte *Osman Kordha*, por unë, ende i pajekur, ende kungull i pabërë, i shkruaja llagapet e bashkëvendësve të mi për së prapthi dhe shëmtueshëm, ashtu si nuk duheshin shkruar. 25.I. *Kolë Maleviqi*, ishte *Kolë Malanj* nga Pinçi. 1.II. *Fran Kolloviqi*, është Fran Kolanj nga Lukiqi, ndryshe *Frani i Pjetrit Kol's Sim's*. 13.II. *Ramo Kollareviqi*, ishte *Ramo Kollari* ose *Ramoja i Beqirit*, me prejardhje prej Ljarjet. 14.II. *Zef P. Dediqi*, ishte *Zef P. Dedanj*, banor i Krythës, me prejardhje nga Dedanjt e Shestanit. *Nikë Junkoviqi*, ishte *Nikë Junku* ose *Nika i Gjergjit*, me prejardhje prej Dobrecit pranë Ljares. *Junkajt* ose *Junkët* janë familje kontësh prej më se 700 vjetësh. 12.III. *Gjoka Daboviq*, jam unë, i cili ia dhashë pak parë vlerësimin vetëvetes. 15.III. *Vojin Janinoviq*, ishte *Vojin Janina*, banor i Krruçit, me prejardhje nga Janina jonë, që na e ka greqizuar Greqia. Atje grek, këtu malazi. Nëse shkonte në Kongo, si do t'ia bënte me lëkurën e vet? 26.VIII. *Vukë Nika Vukmarkoviq*, ishte *Vukë Nika Vukmarkanj*, nga fshati Dedanj. *Gjon Palë Marvuçiqi*, ishte *Gjon Palë Maruçiqi*. Këta thuhet se janë të ardhur nga Palabardhi, një krahinë e hershme arbërore, e sllavizuar para më se 2 shekujsh. Llagapi i tyre, me sa duket, është prurë i tillë prej andej dhe nuk u thoshte askush *Marvuçanj*. *Gjon Stankoviqi*, ishte *Gjon Stankanj*, banor i Dedanjvet, me prejardhje nga Nënmalit i Shestanit të Poshtëm, ndryshe, *Gjon'i Lucit Stjep's*. Kështu i pata shkruar atëherë, kështu i shkrova edhe gjatë përkthimit, për të mos dalë sikur unë paskam qenë qysh atëherë i arrirë në njohjen e vetëvetes.

Këtë gabim të rëndë, tjetërsimin e llagapevet, sikur llagapet të ishin SHAMI QURRASH, do ta kuptoja shumë shpejt dhe, të paktën për vete, do ta korigjvoja një herë e mirë. Mirëpo, fatkeqësisht dhe mjerisht, shumica e bashkëkrahinasve të mi vazhdojnë edhe sot ta PËRGLASIN vetëveten, duke i shkruar llagapet, madje edhe emrat, me formë të huaj. Unë s'kam ç'bëj tjetër, veçse të përsëris me vetëveten: *Mjerë bashkëkombësit e mi, jo vetëm bashkëkrahinasit, por të gjithë ata bashkëkombës që nuk po e kuptojnë sa TË NDYTË duken ata llagape e ata emra, aq shëmtueshëm të tjetërsuar!*

Pezmatimi më shtohet edhe më shumë, kur dëgjoj të pëshpëritet, tinëz e prapa krahëvet: *Është ai që e ka NDYRË, vetëveten edhe fisin e Daboviqvet, duke u vënë fëmijëvet emra TË HUAJ!* (Në një kohë kur emrat e fëmijëvet të mi janë: *Dardan, Ulkinë, Aulon, Molos, Ditjonë*. A mund ta kuptojë lexuesi, të paktën lexuesi shqiptar, ç’ dhibje sjell një i këtillë absurditet injorantësh?!

14.I. „*U nisa për në Togjemil*“. Togjemili është një fshat 6 km në verilindje të Tivarit Nalt. Ne kishim aty një tokë tonën, që im atë e kish marrë në këmbim të një shtëpie në Stamboll. Ndenjëm aty disa vjet. Më vonë ajo tokë është shitur. Rruga nga Krytha e Ulqinit deri në Togjemil ishte diku rreth 36 km dhe unë e bëja atë më këmbë.

Po i llogaris, PËR KURIOZITET, të gjithë udhëtimet që kam shënuar në këtë ditar. Togjemil – Maranj 4 km, Togjemil – Gurrzë 10 km, Gurrzë – Krythë 47 km, Togjemil – Tivar Poshtë 9 km, Togjemil – Gurrzë 8 km, Togjemil – Murrize 4 km, Gurrzë – Vir 15 km, Togjemil – Zalef 9 km, Krythë – Tivar Nalt 30 km, Gurrzë – Ujmir 22 km, Ujmir – Krythë 25 km, Krythë – Ulqin 5 km, Tivar Poshtë – Shestan 20 km, Gurrzë – Murrize 4 km. Këto janë largësitë, kuptohet, të përafërta. I kam përshkuar këto largësi, herë njëherë, herë tjetër, herë 2 apo 3 në të njëjtën ditë, dhe më del që kam ecur MË KËMBË, nëpër këto largësi, pa llogaritur ecjet nëpër mal si bari apo në afërsi të vendbanimevet, në punë të ndryshme, plot 1823 km. Të ishin këto ecejake frytdhënëse, kush po i qante?

15.I. “*25 dinarë marmellatë*”. Këtu shihet më së miri SHKALLA E MJERIMIT, në të cilën jetonim, jo vetëm unë, por mijëra bashkëmoshatarë të mi, në atë shtet që quhej *Jugosllavi Socialiste*. Në llogaritë e mia ditore do të haset disa here kjo e famshmja marmellatë.

1.II. “*Fran Kolloviqi... me pak duhan*” . Frani merrej me kontrabandën e duhanit, punë që ish mjaft e rrezikshme. Por, me çfarë mund të jetonin tjetër të rinjtë e krahinës sonë?

9.I. „*Shara Pikaloze e Ramos*“. Dhentë që i ruanim, nuk ishin të gjitha të familjes sonë. Ato ishin të një Ramoje, që unë tash e kam harruar, dhe të një gruaje, që unë e quaj Mujovicë e që gjithashtu e kam harruar. Nuk e di se me çfarë kushtesh, me çfarë marrëveshjeje i ruanim ato bagëti. Gjithsesi, kjo është dëshmi që, familja jonë, e cila, deri në vitin 1945, kish pasur të vetat afër 100 krerë bagëti e tash detyrohej të ruante të huajat, kish rënë në varfëri të rëndë.

10.II. “*Rruga e Shkinavet*”, toponim në Malin e Krythës. Mbas vitit 1880, kur Ulqinin e kish pushtuar Mali i Zi (me ndihmën e Fuqivet të Mëdha, por edhe me ndihmën e ushtrisë turke), në Gjiun e Valdanosit qenë vendosur disa kolonë

malazias. Gratë e tyre vinin për dru në Malin e Krythës. Rruga nga kalonin, të ngarkuara me dru, u quajt *Rruga e Shkinavet*. Edhe sot ashtu quhet.

13.II. „*Valle te Ramo Kollaroviqi*“. Në netët e dimrit, në fshatrat tanë, pothuaj çdo fundjavë, mblidheshin njerëzit, të rinj e të moshuar, dhe luanin valle. Kështu është shprehja: *Me luojt valle* dhe kjo ish shumë e lashta *VALLJA E SHESTANIT*, në të cilën mund të këndoheshin, në një natë të vetme, 50 këngë apo edhe më shumë. Këtë valle e kam përshkruar hollësisht në vëllimin e parë të librit „*Shestani*“.

Te Ramoja mblidheshim me qejf *me luojt valle*, sepse ai kish një shtëpi, të trashëguar prfej xhaxhait të vet, Litit, dhe ish me dysheme dërrase. Vallja e Shestanit luhet mirë, o në lëmë, ose në ato shtëpi që kanë dysheme dërrase.

25.II. Është ditëlindja ime dhe kam shënuar aty një të dhënë tepër të rëndësishme, jo vetëm personale, por edhe kategoriale. Pesha - 58 kg, lartësia - 157 cm, gjërësia e supevet - 41 cm, perimetri i gjoksit - 74 cm. Sot, që jam 77 vjeç, pesha ime është 78 kg, 20 kg më shumë se atëherë, lartësia 175 cm, 18 cm më i lartë se atëherë, gjërësia e supevet 50 cm, 9 cm më shumë se atëherë, dhe perimetri i gjoksit 105 cm, 31 cm më shumë se atëherë. Diferencat janë të mëdha. Normalisht nuk duhej të ishin, sepse, në moshën 17 vjeç njeriu, normalisht, duhet t'i jetë afruar rritjes së plotë. Mirëpo, kjo është PASQYRA më adekvate E JETËS SË VËSHTIRË. Pasojë sidomos e ushqimit të pamjaftueshëm. Do të duhet të kalojnë edhe gati 2 vjet, që unë të marr një bursë nga komuna e Tivarit, të shkoj në Nikshiq, të vendosem atje në konviktin e Shkollës së Mësuesisë, dhe, brenda vitit të arrij përmasat që i kam sot. Mbase edhe më të mëdha, sepse edhe pleqëria e rrëgjon njeriun. Shkaku: USHQIMI I BOLLSHËM I KONVIKTIT. Them *I BOLLSHËM*, duke pasur parasysh çfarë haja, apo hanim, në shtëpi. Përndryshe, dihet sa *I BOLLSHËM* mund të ish ushqimi i konvikteve.

Nuk është fort lehtë të kuptohen këto gjëra. Mijëra të rinj, të një pjese të popujvet të atij shteti, por sidomos TË RINJ SHQIPTARË, nuk e kishin të mjaftueshëm ushqimin. Prandaj dhe lindnin revolat perfide, prandaj dhe mbinin grupet dhe organizatat e fshehta dhe prandaj mbusheshin burgjet, edhe me kundërshtarë politikë, edhe me deliktuentë ordinerë.

28.II. Vajza, të cilën e kam përmendur këtu, nuk më kujtohet fare.

5.III. “*Vendos një bravë në derën e shtëpisë në Gurrzë*”. Është për t'u shënuar: Gjatë gjithë dimrit, ndërsa ne ishim në Krythë e në Togjemil, dera e shtëpisë në Gurrzë rrinte pa bravë. Në shtëpi kish kaca me djathë, kish patate, qepë të thata, drithë, orendi, dhe nuk hynte askush për të vjedhur. Në Shestan nuk ka pasur “*traditë*” vjedhjesh e grabitjesh, siç kish në disa vise të tjerë të Shqipërisë apo në Mal të Zi. Ka pasur vetëm aty-këtu në të rrallë ndonjë që vidhte.

8.III. “*Ruajta dhentë pleja në grurin e Rizasë*”. Praktikë që njihet, por unë po e shënoj. Në muajin mars kulloteshin të lashtat me bagëti të imëta, në mënyrë që, në prill, maj e tutje, të mos tejrritëshin e të mos rrëzoheshin. Kështu thuhej: *Të lashtat, kur kanë pleh, rriten tepër, rrëzohen dhe, as nuk e rritin, as nuk e pjekin kokrrën.*

13.III. *Lubica* ka qenë një grua me prejardhje nga Kuçi. (Kuçasit janë arbër, të cilët janë sllavizuar para se ne, arbërit e tjerë, të quheshim shqiptarë). I jati i Lubicës, Miqo Tomoja, si u pushtua Ulqini prej Malit të Zi, pat ardhur në anët tona me gjithë fëmijë, por s’kish, as shtëpi, as mjete jetese. Gjyshi im, Gjeli i Nik‘ Pjetrit, si njeri i dhimbshëm që ishte, humanitar e altruist i lindur, i lëshoi kuçasit një kasolle (mbuluar me tjegulla), që e kish në Ograjë, dhe i dha 3 a 4 dhi, që të ketë me se të ushqente fëmijët. Qysh atëherë, 2 familjet e ruanin miqësinë dhe, kur unë isha në klasë V, *Lubica*, tashmë grua e moshuar dhe e ve, me të jëmën gjallë dhe me 2 vajza të rritura, por të pamartuara, më mbajti mua 1 vit në shtëpinë e vet, me qëllim që ta kisha shkollën afër. Nuk guxonte kush as me gisht të vogël të më prekte, sepse kish të bënte me Lubicën e Miqo Tomos.

15.III. Familja Janina ish një familje ortodokse shqiptare e ardhur nga Janina dhe e vendosur në fshatin Krruç të Ulqinit. Duke qenë ortodoksë, djemtë e asaj familjeje qenë martuar me vajza malaziasë dhe, në kohën kur isha unë fëmijë, ata pothuaj ishin sllavizuar, ndonëse shqipen e flisnin njësoj si ne. Ishin sllavizuar dhe bënë politikën e sllavëve në fshatrat tanë.

20.IV. „*Z.O.M.*“ Janë inicialet e një vajze, të cilën unë sot, mbas 60 vjetësh, nuk e kujtoj fare. Kjo dëshmon që, në atë njohje tonën, nuk ka pasur asgjë të konkretizuar.

25.IV. (Fill pas kësaj date) “*Vargje shqip me shkrim cirilik*”. Është një nga krijimet e mi rapsodikë të atyre viteve. Rapsodinë e parë e kam krijuar dhe shkruar, shqip, por me shkronja cirilike, në vitin 1952, kur isha 14 vjeç. Rapsodia bënte fjalë për një martesë me dashuri, duke prishur fejesën e imponuar. Unë e mbroja aty martesën me dashuri dhe isha kategorikisht kundër fejesavet të imponuara. Ngjarja kish ndodhur vërtet dhe unë e kisha shkruar rapsodinë pa i ndryshuar fare, as subjektin, as emrat e protagonistëve. Dajës tim, Gjergj Margjonajt, i cili edhe vetë krijonte këngë, i kish pëlqyer rapsodia ime dhe e kish përhapur. Kjo kish bërë që, një ditë, të më zinte pritë i vëllai i heroit vajzëgrabitës (në një vend ku nuk shihte as dëgjonte njeri) dhe të më kërcënonte: “*Nji u knotht kun ajo kangë, KAM ME TA KPUT KRYET!*” Por unë vazhdova edhe më vonë, e vazhdoj edhe sot, të shkruaj tekste, për shkak të të cilëve edhe do të mund të më “*këputej kryet*”.

„*A më mirë fshatar apo punëtor?*” Shkrim, në të cilin shihet se kishin filluar të më shqetësonin problemet sociale. Gjendja e fshatarësisë, në të quajturën “*Jugosllavi*

Socialiste”, e cila edhe ish e tillë në shumë apekte, sa vinte e po keqësohej. Sot, jo vetëm në shtetet e Ish-Jugosllavisë e në Ballkan, por në shkallë botërore, shpërbërja dhe braktisja e fshatit (rrjedhimisht, tejfryrja e qyteteve), është një nga plagët që po e çon njerëzimin në kriza sociale e financiare nga më të frikshmet.

Duke i parë emrat e 2 personazheve të këtij shkrimi, njëri Jovan, malazias, e tjetri Kasem, shqiptar, shihet që kishin filluar të më shqetësonin edhe problemet e kombit. Shumica e popullsisë shqiptare ishte fshatare dhe ajo, përgjithësisht, vuante nga skamja.

“*Sapo i ka derdhur dielli rrezet*”. Është një skicë letrare, një nga sprovat artstike, me nuanca romantizmi, ku përpiqem ta paraqes fshatin si një parajsë, në një kohë ku, pak më parë e tregoja „*matematikisht*“ se jeta e fshatarit ish një ferr i vërtetë.

Në këtë skicë hasen edhe elementë etnografikë nga jeta e shqiptarëve të Shestanit.

Aty ku kam përmendur Kristofor Kolombin, shihet edhe qëndrimi që unë kisha, qysh në atë kohë, ndaj SHBA-së. S’e di pse më ish krijuar një e atillë bindje. Jugosllavia i kish miq të ngushtë amerikanët.

Vazhdojnë edhe tentativat për të sajuar vargje shqip. Ata vargje janë krejt në frymën e baladave tona popullore. Tema e dashurisë është plotësisht e justifikueshme për moshën që kisha, mirëpo, niveli, siç shihet, është i paarrirë, shumë larg nivelit të baladave të mrekullushme që Shestani i kish rtuajtur me qindra vjet.

Rëndësi ka që, tashmë, KISHA FILLUAR TË SHKRUAJA SHQIP. Shkronjat ishin sllave, cirilike, por fjalët ishin shqip dhe KJO PËR MUA KA SHUMË RËNDËSI. Unë, tashmë, po e njihja vetëveten! Po filloja të kuptoja kush jam e çka jam! 8 lkasë shkollë, e huaj, më kanë mjaftuar të paktën për të marrë vesh përkatësinë time kombëtare! Askush nuk më ka ndihmuar konkretisht në këtë proces! Askush nuk më ka përkrahur, deri sa kam shkuar në Kosovë, vetë, pa më çuar njeri! Dhe kjo bën që, kur të vdes një ditë, të vdes me vetëdije të qetë.

15.VIII. “*Kemi kcyer malazezçe*”. Është një kërcim djalë e vajzë, përballë njëri-tjetrit, në distancë 2-3 metra, që, në Shestan, i thonë edhe *KRUSHQISHT*. Në të vërtetë, malazezët, në shumicën e tyre, kanë prejardhje arbërore, mbi 60%, sipas disa studiuesve, dhe është afërmendsh që të kenë trashëguar shumë elementë etnikë e folklorikë nga paraardhësit e tyre arbër. Midis tyre, edhe kërcimi në fjalë duket se është i proveniences iliro-arbërore. Por unë, në atë kohë, vetëm me një shkollë 8-vjeçare, edhe ajo në gjuhë të huaj e pa as edhe një informacion për kombin tim, nuk mund t’i dija këto gjëra. Prandaj dhe i them: *malazezçe*. Ashtu siç i thonë edhe sot të gjithë bashkëkrahinasit e mi, që nuk e kanë pasur fatin të arsimohen në

gjuhën e kombit të vet. As fatin, as vetëdijen dhe as guximin për t'u shkundur prej robërisë shpirtërore dhe për ta kërkuar shkollimin në gjuhën amëtare.

8.IX. “*Fjeta te Ramoja i Zekos*”. I gjithë ky ditar, nga fillimi në fund, tregon marrëdhënie TË SHKËLQYERA ndërkonfesionale në të gjitha trevat e Tivarit e Ulqinit. Myslimanë dhe katolikë shkojnë njëri me tjetrin si të ishin farefis. „*Fjeta, them, te Ramoja i Zekos*“. Në raste të tjerë: „*Erdhi Fatma e Isufit për të ndenjur*“, „*Në mbrëmje, te Rizaja, deri në 12*“, „*shkova te Sulo Smakoja*“, „*Ndenije te Osman Kordiqi (Kordha)*“. Pa kurrfarë kompleksi, dhe ky është një nga virtytet më me vlerë të kombit tonë, që nuk kanë pushuar kurrë (dhe jo pa sukses) dhe ende nuk po pushojnë as sot së përpjekuri për të na çorientuar.

Pas datës 12.IX.

Shohim, më në fund, një këngë të plotë, hartuar mbi subjektin e një martese me dashuri. Është shkruar shqip, në të folmen e Shestanit. Në mos për tjetër, për një dialektolog mendoj se ka vlera të pamohueshme.

„*Probleme të spitalit të Tivarit*“ (Sllavisht) Jam marrë sërish me një problem të rëndësishëm social. Del edhe këtu gjendja e rëndë e fshatarit. Qenia shoqërore, thonë, e përcakton ndërgjegjen e njeriut. Gjuha shkon ku dhemb dhëmbi.

Dhe, në fund të fletores, apo afër fundit, kam bërë përpjekje të hartoj një POEMË PATRIOTIKE (shqip). Stili është edhe këtu tërësisht folklorik. Vlera dialektologjike është edhe këtu e pranishme.

Por unë kam një arsye tjetër për t'u krenuar me këtë krijim të rinisë sime: TIVARIN E KAM KONSIDERUAR QYTET SHQIPTAR qysh në atë moshë dhe pa kurrfarë arsimimi kombëtar. Nuk ka qenë aspak e lehtë për mua të veçohem dhe të ndahem aq prerë nga opinioni mbytës që ish krijuar nën presionin e pushtuesit. Askush prej moshatarëve të mi e as prej më të vjetërve, nuk e pohonte, nuk thoshte që *TIVARI ISHTE NJË QYTET SHQIPTAR*. As sot nuk e thonë. Madje as Shkodra nuk thotë që *TIVARI ËSHTË PJESË E SHQIPËRISË*. Një verbëri e padurueshme! Janë sllavizuar pothuaj të gjithë bashkëkrahinasit e mi! Po e përsëris: E kam pasur shumë vështirë! Megjithatë, kam bërë punën që duhej të bëja dhe për këtë kam të drejtë të ndjehem krenar!

Pjezë, 20 gusht 2015.

SHTESË

Duhej të kalonin 7 vjet, që unë ta kisha përcaktuar tashmë përfundimisht rrugën time të jetës: Isha anëtar i një organizate ilegale, e cila punonte (me një program sa serioz, aq edhe larpamës dhe të parrëzueshëm edhe sot e kësaj dite), për çlirimin e tokavet të Shqipërisë nga pushtimi sllav. Kisha një përvojë solide në mbledhjen e folklorit në trevën e Shestanit, lëndë që kish filluar të botohej te revista letrare “*Jeta e re*” në Prishtinë, dhe, në krijimtarinë artistike letrare, nuk isha më një imitues i folklorit.

Këtu po RIBOTOJ, si shtesë të këtij ditari, disa nga poezitë që m’u patën botuar në vitin 1962.

Te revista “*Vllaznimi*” e Shkollës Normale “*Dimitrije Tucoviq*”, kam 6 paraqitje të zhanrevet të ndryshëm: 1. Një intervistë me Sekretarin e Komitetit të LKJ-së për Prizrenin, Refki Dautin, bashkautor me njërin prej shokëvet të mi më të ngushtë, Haxhi Zybën. Është, pra, një fillesë gazetarie. 2. “*Para shtatores së Dimitrije Tucoviqit*”, përsiatje. 3. 3 poezi në gjuhën shqipe: “*Atje...në Jug*”, “*Rumiya*”, “*Ulqini*”. 4. 1 poezi në gjuhën sllavojugore qendrore: “*Odbijam ljubav gazdarici*” (“*Ia refuzoj dashurinë bujtinares*”), e cila ishte, në të vërtetë, një MANIFEST ALEGORIK mbi qëndrimin që duhej të mbanim ne shqiptarët ndaj shtetit jugosllav. 5. “*Lyra*”, poezi. 6. Një hartim në gjuhën sllave, fitues i një çmimi shkollor: “*Koje ljude volim i cijenim*” (“*Cilët njerëz i dua dhe i vlerësoj*”). Në atë kohë Republika Popullore e Shqipërisë po jepte shenja afrimi me Republikën Popullore të Kinës, dhe ne e quanim të nevojshme të shprehnim simpati ndaj këtij afrimi.

ATJE...NË JUG

Hana qesh me detin/ Deti pasqyrë e thyeme,/ Era luen me qiell/ E qielli pëlçet e ngrihet ullishta./ Det i detit/ Si deti/ Pranë detit ushton./ Qesh me hanën/ Gjëmon/ E n’gaz shkrin vetveten./

RUMIJA

Rraja shkamb/ Kunora shkamb/ Shkamb mbi ty e/ Shkamb nën ty/ Shkamb i tanë./ Me zogj prej shkambit/ Ujë prej shkambit./ Borë prej shkambit/ Shkambij fryma dhe era/ Shkambij rrugët dhe jeta/ Shkambij njerëzit-/ Në majë të shkambit./

ULQINIT

Kështjellë pranë valëve/ Pjellë e tregtarëve/ Viktimë e barbarëve/ Strehë e kusarëve/ Lavdi e të parëve./ JE/ O prag i thyemjes së valëve/ O arkë e drujve të verdhë/ O maj i hundës së barbarëve/ O ngrohje e atij që s'do zinxhir/ O gjak i ngrimë i gjyshit tim./

(*maj, vare, çekan)

IA REFUZOJ DASHURINË BUJTINARES

(Shkruar sllavisht. Shpërim i lirë. Gj.D.2015)

Oh, mund, mund të të dua,/ se ti je fqinja ime – me dhomë,/ o agresion,/ por jo si grua/ që sundon mbi mua.// I dua brigjet e tu të fryrë/ bulëzat e tua/ sardele,/ meze qerasjeje,/ por s'më vjen mirë kur thua:/ Ti je imi,/ ti je unë,/ ti je një përrua i përmallshëm/ që e shkrin veten në mua./ Sepse, ti je grua, o fqinja ime,/ e bukur ndoshta,/ por burrit tënd,/ pas një kodi të vjetër,/ i takon përemri pronor.// Të 2 sytë e mi/ të zënë rob prej kohësh,/ pranë një shkëmbi ndanë detit/ në një fshat prej guri/ janë ligj i qenies sime;/ pas tyre digjen/ 2 bakushet e kësaj zemrës sime.// E, ndërsa këtu bebëzat e Zotit tend/ me buzë dinake/ gjuajnë naivitetin e gjoksit tim,-/ AJO/ dhe sytë e saj/ dhe buzët/ dhe lulja e flokborës së saj,/ në papafingo është duke pritur;/ e djeg malli/ vuan/ tretet/ jo si ca sy artificialë/ por si sy nëne.// dhe prandaj/ unë mund,/ mund,/ mund,/ por nuk dua të mund,/ sepse t'u gjuhëzohesh buzëvet të tua/ do të thotë ta gënjesh veten;/ sepse AJO, atje nën çati më takon mua -/ unë jam shpresa e saj./

(Alegoria është fare e kuptueshme: Bujtinaria është Sërbia, AJO pranë detit është shteti shqiptar. Çuditëmi si i ka shpëtuar censurës, pasi dihet që krejt materiali që publikohej, kontrollohej më parë prej UDB-s. Gj.D.2015)

LYRA

Fillova me këndue si ju/ por kanga/ fjala e saj si guri/ tingulli i saj si qyp me voj/ ah ju kënduet dje për dje/ e sot/ tjetër kangë po lyp/ kupa e venës/ që vetëm tash pihet/ për tash/ me tashin bashkë/ që kangës së djehit s'i thotë/ fjalë fyese/ që të nesërmen e çmon për nesër/ sot voji në qyp nuk rrin/ dhe kanga hyp në qiell/ por jo në shpinën e Pegazit/ por në krahët e kohës sime/ në SA dhe n'TE/ dhe LIT/ që s'asht zavalë imagjinatë/ as e lume/ as qylym hinas/ por ferum me dorë i flakun/ me alfën time/ unë jetoj në kthetrat e tua/ jetoj me mish balene/ elektroni asht ekran/ SPUTNIKU Pegaz, si thashë.../ Jetoj! Jetoj!/ dhe thom çka dua/ thom çka di/ çka shoh./

Te revista “*JETA E RE*“, nr.1, 1962, faqe 140-142, më qenë botuar 2 vjersha: “*Nesër*” dhe “*Pse*”. Ishte rasti i parë që dilja në një organ letrar nacional. Kryredaktor ishte ESAT MEKULI. Ai i botoi këto 2 vjersha dhe më shkroi menjëherë një letër. Ajo letër, për mua, ka qenë, jo letër, por avion, dhuratë prej atit të madh të të gjithë shkrimtarëve shqiptarë, ndodhur dhunshëm përtej kufijvet të shtetit të vet. Me atë „*avion*“ do të fluturoja tash e tutje mbi qiejt plot me re, duke bartur me vete, veç shumë thasëvet të tjerë, EDHE NJË THES TË RËNDË ME POEZI. Kam hasur më vonë bashkëkombës, që i dinin përmendësh të dyja këto vjersha. S’e di ç’i kish shtyrë t’i mësonin përmendësh, aq më tepër, kur asnjërit prej tyre nuk mund t’ia merrte mendja se do të më takonte ndonjëherë, por e di që i dinin dhe kjo më krijonte komoditet në „*avionin*“ tim.

NESËR...

Nesër nuk di kush je/ Nesër asht jeta ime/ Nesër je ti/ Nesër vilën due/ Veturën due/ Bashkë me ty e me ty/ E me tjetrin e me at tjetrin/ E me të gjithë.// Romanin e shkruaj nesër/ Ty të puth nesër/ Nesër nuk dij kush je/ Se nesër dielli nxen/ E unë thnegla do të mbledhi/ E njerëz do të mbaroj prej tyne/ E tambël do të pi/ E do të vij te ti/ Se – veturën due/ Vilën due/ Se ty të due për mue/ Për nesër/ - Sepse nesër/ Pa shpresë për nesër/ Unë s’i due/ As ty/ As vilën/ As thneglat e mija/ Pa nesër/ As jetën s’e due./

PSE...

Pse po më thue se nuk kam shpirt/ Kur psehi im asht mbytë/ Në psehin e psehave tjerë?/ Sot pse i thonë tërmetit/ Sot asht psehi ma i madh se dje/ Koralet janë pse/ Pse asht edhe nata/ Leka i Madh asht pse/ Pse janë Marsi e Pegazi/ Pse asht Zoti/ Titovi dhe Gleni/ tërplota/ Pse asht dhe lufta në Kongo/ Pse jam edhe unë/ Që pyes për psehin/ Pse asht psehi.// Unë due ma pak pseha/ Por psehin vetë thrras/ - Eja pse dhe më thuej pse ka deti ujë/ Pse kemi qiell/ Kosmosit ç’i duhet psehi?// Pitagora psehin e ka në ketete/ Psehi n’aritmetikë/ asht mik i dobët/ Psehi më shtje me puthë/ Psehi asht frigë/ asht krymb/ Se bomba ka psehin e madh/ (Ajo nuk hahet me djathë)/ Ajo rri në dorë të psehit/ E dora ka trunin pse/ Truni asht strajcë me pseha/ Nanë e banesë e psehit.// Ti je pse, e dashtun./ Kur dalim në mbramje/ Vorret janë pse/ Nata asht për puthje/ Këlkaza/ Bari/ Ti je pse pranë psehit/ E puthjet puthin psehin.// Kush e di se deri kur do të jem unë pse?/ Psehi më jep frymë e fjalë/ ai më shtyn/ Me hangër/ Me dashtë.../ Me pyetë për të/ Me u tutë prfej lufte botnore/ Psehi më shtyn me pyetë Hrushkenedin/ Pse mban bombën nën sqetull?/ Psehi më mban me shpresa/ Se vetë asht pse/ Se njeriu nuk mundet pa pse/ Se psehi vdes pa te./

Po në atë numër të „*Jetës së Re*“, faqe 123 – 124, më qenë botuar edhe 2 këngë popullore, *MOJ NUSE GJELINA JEME* dhe *ATJE POSHT-E N'ATO THANA*, kënduar nga Prenë Dabaj, amvisë, katundi Gurrzë, Shestan.

Në numrin 2 të „*Jetës së Re*“, 1962, faqe 287 – 289, më dolën 2 vjersha të tjera: „*Te bedemi pranë saj*“ dhe „*Prifti pa fe*“ (me titull gabim). Këtë të fundit, „*Prifti pa fe*“ e shkrova, sepse isha i pakënaqur me 3 të parat, sidomos me formën e tyre, dhe, me sa duket, pata vendosur të mos shkruaj më me atë formë.

TE BEDEMI PRANË SAJ

E dashtun -/ shpirt e zemër,/ gëzim i shpresës,/ gjumë i bankës,/ andërr çastesh me grushta në dorë/ prishje qetsije n'orë/ idhnim i prof-it të vjetër -/ ti e kurrkush tjetër...// (Ah muzg/ mbulomi mollzat e ajuna/ guacat e kalluna/ hidhmi në krahët e buzëve t'saja!)// „Mos, po tutem!/ Të lutem...“// Shih -/ drita e verdhë pushtoi qytetin/ e na/ a kemi nevojë me e mshefë dashnin?/ Babat e gjyshat tanë/ kanë puthë buzë me shpatë në dorë/ kobure në brez/ e mollzat e tyne/ mësheftas janë fikë e ndezë./ Po ti?/ Po unë?// (Oh bedem i grryem me thojt e kohës,/ ngreje zanin e mykun/ kalle topin e iftarit -/ tregoji botës/ fol/ bërtit/ kallzo – se unë/ martir i shkambit t'egër/ çova sytë e ulun poshtë përdhunë;/ po di ku jam e çka jam/ lumnin e çova pezull!/ O, myshk!/ O frymë e plasun!/ O byk!/ O Bar!/ O jam i fortë si kurr ma parë -/ si mëngjez i verdhë pranverë!)// Mundem me të dashtë, e l u m t u n/ mundem krejt me të futë nën kapakun e krahnorit/ mundem klithjen me ta thye me puthjen time.../ Por – shih njiherë do mjekrra të thime/ do plasa me djersë e myk/ se si PO-hin tonë p'e shohin/ dhe PO po del nga goja e tyne -/ PO i lyem/ PO i thyem/ PO i fyem.// Shih: sybakri (uh, tërqethje!)/ si vajton... vajton në heshtje/ loti i tij ia lag kujtesën/ sepse -/ burg ka qenë suaza e kohës/ frigë/ dashni e djegun thatë.../ (Ah sa më dhimbet zemra e gjyshit -/ gjyshi i ngratë!// -----/ E dashtun -/ të shkojmë sonte/ (nesër mbrama/ prapë na qesh hana!)/ Ta mbyllim flakën e puthjes njëherë në vehte/ për hir-kujtesë/ të sybakrit që po vdes/ për dridhje të mbylluna nën brij/ me shekuj -/ për mjekrra që po dridhen sot me mall.../ Të shkojmë! Të shkojmë!//

PRIFTI PA FE

Boshti bahet barikadë – madej/ bisha nuk bleron – mandej/ baba burr' i botës – mandej/ bromi, barku, zorra qorre – mandej/ boks, e bardo, barcelona...// I marrë je, o prift pa fe!/ sepse -/ kanga kur këndohet – nuk/ këndohet kot për kot –nuk/ përzihet voj me breshën – nuk/ leh qeni në thana të thata – nuk/ di ti se ç'asht publiku!/ Vështirë asht me qenë poet./

Esati i pat përkthyer këto poezi edhe në gjuhën sllavishte jugore qendrore dhe, kur njëherë shkova në zyrën e tij, më priti gjithë përzemërsi dhe, ende pa u ulur, më tha: “*Qe, t'i kam botue edhe te revista Stremljenja.*” E hapi revistën dhe m'i lexoi

vetë, pastaj më pyeti: *“Si të duket përkthimi? Jam mundue me i përkthye mirë. Ti më ngjan me Vasko Popën e ktyne. Ai është njohës i mirë i folklorit, por shkruen me një stil sa ma larg prej folklorit.”*

Në numrin 3 të *“Jetës së Re”*, 1962, faqe 442 – 449, më qenë botuar një tufë prozash popullore: *QIROSA ME DY VLLAZËN*, tregue prej Stjepë Zefit Dabanj, *VAJZA DEMELE*, tregue Prenë Dobrecanj, *ËSHT MARTUO UJKU*, tregue Gjergj Dabanjt dhe *KA KJEN SHOQJA NJI PASHS*, tregue Stjepë Zefit Dabanj.

Në numrin 5 të *“Jetës së Re”*, 1962, faqe 681 – 686, më qenë botuar 4 këngë popullore, *VRITEN E PRITEN DY MALE*, *U NJIT DJALI RROG ME VASH*, *ATJE POSHT-E NË MAHALL*, *ULU MAL*, *TË DALE HANA*, të gjitha këndue Prenë Dabanj.

Në numrin 4 nuk e di a qe botuar gjë, por krejt kjo, nga numri 3 e këndeje, ka një histori. Unë tashmë e kisha kaluar kufirin shtetëror. Esat Mekuli më çonte honoraret, por ata i kthente posta. Dikur, pyet një shokun tonë, Idriz Ulajn: *“More Idriz, po ku është ky Gjoka, se posta po m’i kthen mbrapsht honoraret?”* *“Gjoka ka kalue kufinin qysh në verë,”* i thotë Idrizi. *“Auu!”* Ia bën Esati. *“Mirë që më kallzove, se na piu e zeza! Tash po na padisin, se bashkëpunojmë me anmiqtë e Jugosllavisë!”*

25 gusht 2015

Gjokë Dabaj